

# Oral History Kosovo

---

## INTERVISTË ME RIZA KRASNIQIN

Prishtinë | Data: 30 janar, 2016

Kohëzgjatja: 112 minuta

Të pranishëm:

1. Riza Krasniqi (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Jeta Rexha (Intervistuesja)
4. Noar Sahiti (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Riza Krasniqi:** Quhem Riza Krasniqi i lindur me 3 korrik, 1959, në qytetin e Pejës, ku e kreu edhe shkollën fillore dhe të mesme. Fakultetin Teknik, Dega Elektro e kam kryer në 1977-1982 në Prishtinë. Kurse, prej 1 tetorit 1992 deri para luftës, kam punu si profesor i informatikës në gjimnazin, atëherë “11 Maji”, tash “Bedri Pejani”, në Pejë. Kujtimet e fëmijërisë (buzëqeshë)... po ndoshta kujtimi i parë që ka ndiku te une si njeri është si maturant. Domethanë, isha maturant në vitin 1976-1977 dhe një shok i imi, po vjen në ditë e po thotë, “Rizë, a po vjen me u ba anëtar i Lidhjes Komuniste?” Unë s’disha as çka osht’ Lidhja Komuniste. Thashë, “E çka bajmë na atje si anëtarë të Lidhjes Komuniste?” “Rizë,” tha, “mledhemi me profesorë, i dëgjojmë profesorët t’u i bo fjalët mes veti, o kënaqësi.” Thashë, “Po more”, se kisha edhe dëshirë me i ndëgju profesorët t’u bo fjalë se mendojsha që ata... kur i thashë babës, “Babë qështu, qështu...” ai, “E çka t’u dashtë bre babë?” Thashë, “Bre babë, me i ndëgju profesorët”.

Edhe nihere në ni mbledhje në 1977, u vonumë, u bo ora njimbëdhjetë kur shkova n’shpi, baba ishte duke pritur. Edhe po m’pytë, “Rizë çka bonët n’mledhje?” Thashë, “Jo diçka me randësi, e kemi dënu në shqiptar me vdekje.” Tha, “E pse e keni dënu me vdekje?” “Se e kish vra ni shka.” Edhe ju kuqën sytë. “Eh more babë,” tha, “a jeni shku aty me dënu njerëz, a jeni shkollë? Nuk osht’ shkolla me dënu njerëz.” Thashë, “O babë, njeriu n’ato momente duhet me u nxerrë, po krejt profesorët votunë.” Tha, “Krejt profesorët kanë votu për veti, e ti tha e din që je nipi i Cen Avdylit. Ti e ki jetën tande, ti nuk guxon me bo çka bojnë ata tjerët, ti duhesh emrin tond me...”

Edhe qështu mbërritëm gjithë natën s’më murrë gjumi se ish hera e parë që e pashë babën tem me sy t’përlotun. Domethanë, gjestin që e kisha ba une si maturant, atij shumë i kishte pengu. I kishte pengu se... u fillova me mendu historinë e babës e cila osht’ një histori e një njeriut, i cili lindi në vitin 1919, vdiq me 1996, domethanë lindi dhe vdiq nën okupim. Historia e një njeriu të cilit në moshën... tre muajsh i ka pasë kur ia kanë mbytë babën. Edhe ai këtë historinë, gjithëherë në natën e *Bozhiqit*<sup>1</sup>, se une e kom një vëlla edhe dy motra, natën e *Bozhiqit* na mbledhte si familje edhe na tregonte historinë e babës t’vetë, qysh serbët ia kanë mbytë babën. Domethanë, nata e *Bozhiqit* për ne ka qenë e zezë sepse ma kanë mbytë babgjyshin, ma kanë lanë babën tre muajsh. Dikun njimdhjetë vjeç babës tem i ka vdekë edhe nana. Edhe paramendoni një babë i cili me fjalën babë, nanë, vëlla, motër, axhë, nuk e

<sup>1</sup> Serbisht: *božić*, krishtlindjet.

ka ditë çka osht', nuk e ka ditë çka osht' sepse serbët ia kishin mbytë babën. Serbët e kishin lanë pa krejt. E tash djali i vetë, une, po votoj me dënu një shqiptar me vdekje pse e kish nxerrë gjakun e djalit, e ka vra nji...

Prandaj kjo osht' ajo ngjarja e parë e cila prej atëherë, çdo herë m'ka detyru me mendu, "A thu çka kish thonë baba tash? A thu qysh kish votu baba?" Edhe krejt jetën ma vonë çdo vendim të vështirë që e kom marrë, kom mendu, "A thu çka kish thonë baba Ahmet".

**Erëmirë Krasniqi:** A mundeni me na folë për jetën n'Pejë kur keni qenë ju fëmi, edhe qato zhvillime që kanë ndodh atëhere, ambiciet drejt socializmit, qysh ka qenë jeta atëhere?

**Riza Krasniqi:** Po nëse...

**Erëmirë Krasniqi:** A ka ndërru?

**Riza Krasniqi:** Ka ndërru shumë, se unë si maturant në gjimnaz të Pejës kom qenë në vitin 1973-1977. Edhe jeta e nji gjimnazisti... tash me thanë që n'atë kohë nuk m'ka interesu politika fare, nuk jemi marrë na me politikë. Na n'atë kohë kem [mendu] qysh me msu. Kom lujtë me top, shkojshim me kqyrë atëhere ka qenë "Buduçnosti" i Pejës, një ekipë e futbollit. Të dilleve shkojshim, lujshim me shokë, pa ndonji pretendim që... si student, si student une po e kom vështirë edhe fëmijëve t'mijë me iu tregu. Fakultetin Elektro e kom kry në vitin 1977-'82, edhe ju betohem që fjala 'intervencë' nuk ka ekzistru n'fjalorin tonë. Na në '77-tën i kemi regjistru 150 studentë, në 1982-tën kemi qenë tremdhjetë në vit të katërt, në vit të pestë, n'vit të tretë, katërt, pestë. Po ju betohem që secili e kem ditë se sa po din secili. Edhe asneni kurrë për kohë t'studimeve nuk e ka përmend fjalën 'intervencë', kurse sot jonë do kohna tjera. Atëhere kanë qenë kohna tjera edhe në do aspekte. Kur une e kom kry n'vitin 1982, unë mrenda mujit i kom pasë tri oferta pune. "Kosova B" pat' fillu prodhimin edhe na pat' thanë nji profesor, Naim Hoxha, "Kushdo që vjen në 'Kosovë B', e ka edhe banesën e siguruar." Kur i thashë unë babës tem, "Babë, unë e kom banesën e sigurume." Tha, "E unë me kom me jetu n'Pejë, veç me nanën tande a?"

M'kanë pranu në... se e kom pasë bursën prej fabrikës së autopjesëve "Ramiz Sadiku", në Pejë. Kom shku atje edhe kom thanë, "E kom kry Fakultetin, e kom edhe temën e diplomës, a bon edhe dy mujë me e shty pranimin?" Une kom kërkru me u shty pranimi, s'po du me fillu edhe dy mujë derisa t'diplomoj. M'ka thanë ai, referenti ishte, "Djalë i mirë, ndaq me ia nisë punës nisja, mos ndaq, mos ia nis hiç!" Thashë, "Ditën e mirë!" Pastaj jom shku në gjimnaz të Pejës për krejt diçka tjetër, m'kanë thanë, "A po don me fillu me punu?" Prandaj, edhe këto me ia spjegu rinisë së sodit, sot osht' pak ma vështirë, se pa diplomu mirë i kom pasë tri oferta t'punës edhe secila ka qenë ma e mirë se tjetra. Njena po thomë, ka qenë me banesë. Ta kisha pranu ofertën, sot e kisha ni banesë shumë t'mirë n'atë kohë që e japke "Kosova B", po kohnat po ndryshojnë edhe tash... ma ndryshe.

**Erëmirë Krasniqi:** A mundeni me na folë për familjen e ngushtë, po shkojmë mbrapa pak, për motrën, vllaun e jujë, çfarë familje keni qenë?

**Riza Krasniqi:** Familje mesatare n'atë kohë. Une n'atë kohë, nana ka qenë Shahe Demukaj, ka qenë prej familjes Demukaj, n'atë anë thojnë Sali Rrustaj, familje e famshme e Rrafshit të Dukagjinit e cila t'themi n'atë kohë kanë nda pleqni. Pleqni ka qenë çdo mosmarrëveshje që kanë pasë njerëz n'formë gjyqi. Edhe une e kom shkru... bile në ni moment e di kur n'vitin 1966 kur ka qenë Rankoviçi n'pushtet këtu, edhe ka bo zullum n'atë kohë, ka bo dhunë. Ka shku një kojshi te Sali Rrustaj n'mëngjes, edhe thotë, "Sali, jom ardhë se... çka me ba që me i hekë serbët prej ktuhit, çka me ba që me e hekë Rankoviçin prej ktuhit?" Edhe Saliu qe njeri i mençëm thotë, "Lehtë osht' kjo punë, ulu pije ni kafe edhe unë të tregoj." "Jo," thotë, "tregom qetash se jom n'gjendje me dalë me luftu." I kishte katër djem, "Katër djem t'japim veç me e shliru Kosovën prej Rankoviçit". Saliu thotë, "Ulu pije ni kafe, pastaj të tregoj." Kur e pin ai kojshiu kafën, tash ia di edhe emrin, por s'o me randësi." Thotë, "Sali, çka me ba?" Thotë, "Po, shko prej ktuhit, shko përçafe vllaun tond edhe duje vllaun tond." Se Saliu e dinte që ai nuk kishte raporte t'mira me vllaun. "Jo valla, nuk muj me e përçafë vllaun." Thotë, "Valla, deri sa [nuk] ta përçafë vllaun, Rankovici ka me ndejtë këtu." Ishte porosia shumë e thjeshtë: nëse ne nuk e dojmë njoni-tjetrin, kurrë nuk mundemi me u çliru ashtu siç ne e mendojmë.

Dy motra, motra e madhe Zadjë, në Pejë, e ka ni familje t'qetë, i ka katër fëmi. Motra e dytë, Xhyle Avdyli osht' e martume në Prishtinë, ka dy fëmi t'suksesshëm. Vëllau osht' Cen Krasniqi, punon si profesor në Fakultetin e Ndërtimtarisë, ka dy fëmi. Nëse kthehem kah familja ma e ngushtë, bashkëshortja ime osht' Shpresa Devolli, punon si motër medicinale në spitalin e Prishtinës tani. I kom tre fëmi të suksesshëm, tre fëmi të cilët jonë jashtëzakonisht t'mirë, jo se janë t'mitë po... vajza e madhe Tringa osht' në Universitetin Amerikan, në vit të katërt, vajza e dytë Rina osht' në fizioterapi, në vit të dytë, djali Drini osht' nxanës në shkollën e mesme amerikane. Që të tretë mësojnë, dhe jam i lumtur që kam një familje të tillë.

**Erëmirë Krasniqi:** Zoti Riza, kur pytëm për familje e kemi për qëllim... se kemi qef me e ndërtu një *backstory* [prapavijë] ... njifarë prapavije t'juajën se qysh jeni rritë. Nuk po m'intereson bash çka bon motra ashtu në detale, por qysh ka qenë qajo farë jeta mrena n'familjen e jujë gjatë qasaj kohës edhe a din nifarë...

**Riza Krasniqi:** O tash s'di sa... po meno j n'rregull, osht'... unë jom rritë në ni familje tipike kosovare shqiptare n'atë kohë ku fjala e babës ka qenë ligj. Edhe une e thomë shpesh herë, nana ime ndjestë pastë nuk ka pasë tru t'vetin, ose trunin e vet e ka shfrytëzu vetëm e vetëm me i ndigju komandat e babës. Domethanë, kur ka thanë baba diçka, n'familje time nuk o komentu a osht' qashtu, a s'osht' qashtu. O ditë që baba ka t'drejtë. Domethanë, çkado që ka thonë baba, as nana, e as ne fëmija nuk e kem komentu, ajo ka qenë rregull. Prandaj, si familje edhe ashtu kanë qenë shumica e familjeve n'atë kohë. Ishte edhe koha e tillë edhe jemi mësu n'atë formë.

**Erëmirë Krasniqi:** Ku keni shku në shkollë fillore?

**Riza Krasniqi:** N'shkollë fillore, n'shkollën fillore "8 Marsi", e kom pasë aty afër. E kom pasë ni msuse t'shkëlqyshme, Resmije Kelmendin. M'kujtohet se dëshira e babës për me m'rritë para kohe edhe e familjes, m'kanë çu n'shkollë pa i bo gjashtë vjet edhe s'kom deshtë. Osht' ardhë msusja për çdo ditë

vitin e parë m'ka marrë te shpija për dore m'ka çu n'shkollë, se s'kom deshtë me shku n'shkollë. Edhe i jom shumë falemnderus msuses Resmije Kelmendi, për krejt ato çka kom arritë ma vonë. Shkollën fillore "8 Mars", shkollën n'atë kohë i thojshim ma me mira n'Pejë si çdo shkollë tjetër pa diçka...

**Erëmirë Krasniqi:** Keni vazhdu mandej me gjimnazin?

**Riza Krasniqi:** Gjimnazi "11 Maji", aty kem pasë disa profesorë që përnime kanë qenë Ymer Muhaxheri, Rexhë Gjonbalaj, njerëz me plotëkuptimin e plotë t'fjalës, se sot osht' ma vështirë me gjetë njerëz të tillë. Nji shoqni normale, pa... pastaj kom vazhdu kom regjistru Elektron, e kom kry n'afat. Këto jonë ato ngjarjet të cilat ndoshta si familje çka osht' tash. E tregova historinë e babës, baba o rritë jetim. Une i kom edhe dy motra ma t'mëdhaja. T'dyjat jonë... edhe baba andërr t'jetës e ka pasë me u martu une. Edhe prej moshës 18 vjeçare ka qenë çdo natë, "Babë martohu, babë martohu, se po shef une s'kom kërkon, menxi s'po pres!"

Pasi e krevia fakulltetin, erdha nji ditë i gzueshëm, edhe pa nji i thashë, "Babë e kom gjetë." "E kon babë?" Po i tregoj emrin e ni vajze, tha, "Kon e ka babë?" Po i tregoj, "Kon e ka nonë?" Thashë, "E besa s'e kom pytë". Edhe përnher baba u kuq, u kuq, u kuq. "Kqyre tha, babë..." të thashë që ka jetu n'Skivjan se n'moshën tre mujore kur ia kanë mytë babën, dikun mas gjashtë mujve gjyshi i tij e ka nxerrë gjakun, e ka vra atë serbin. Edhe babën o deshtë në *duqi*<sup>2</sup>... ka qenë do n'fshatëra ato, ju s'e dini çka jonë, o deshtë me çu n'Skivjan te dajtë e vetë, mos me vra serbët. Edhe baba te dajtë e vetë, o rritë n'Skivjan, n'Skivjan e kanë martu. Edhe andërr baba e ka pasë me u martu une, me u rritë familja. Edhe tha, "Ti e din që une jom rritë n'Skivjan," thashë, "Po, babë." "N'Skivjan," tha, "i kem pasë... o deshtë lopën në shtatë fshatëra me e çu sepse..." me emër e tregoi, "njeni e ka pasë nji kâ t'mirë, se për shpi t'madhe, o konë me randësi çfarë viqi ka me u bo n'shpi, e djalit tem nuk po i intereson çfarë viqa kanë me iu ba n'shpi." Thashë, "Babë, unë jom profesor n'gjimnaz, me m'thirrë viq nuk...nuk o bash mirë." "Babë," tha, "edhe shtazëve iu intereson familja. Edhe skjaroja atyne, ti po m'thu mu që edhe n'Amerikë njerëzt kur e blejnë qenin edhe macën, nuk e kqyrin kon e kanë pasë n'familje qeni? Ia kqyrin paraardhësit. E ti po m'thu që nuk...e din nanë kon e ka ajo vajzë. A je n'veti?"

Domethonë, randësinë e familjes une e kom mësu prej ktuhit. Kurse ma vonë, kur ka fillu aksioni për pajtimin e gjaqeve, aty e kom ndëgjju nji tregim që nashta ma s'mirti e ka tregu randësinë e vajzës, randësinë e nuses, randësinë e femrës n'shoqëri.

Tregimi ishte ky, profesor Antoni e tregonte, dy familje, t'themi familja A dhe familja B. Familja A ka qenë familje n'atë kohë me za themi tek ne, domethonë ni familje me renome, familje shumë e mirë që e çmojnë rrethi. Familja B nuk ka qenë familje e tillë, familja B ka qenë familje ma... nuk e kanë çmu rrethi. Po ka ndodhë, çka ka ndodhë, nji anëtar i familjes A e vret nji anëtar të familjes B. Edhe shkojnë tash te familja B edhe i thojnë, "Ti duhesh tash me e falë gjakun, se e din kush osht' familja A. E din çka kanë bo ata", edhe ky i thotë, "N'rregull". Mas ni kohe thotë, "Po e fali gjakun", edhe për me e vu n'ren qysh kanë thanë n'atë kohë, nji vajzë timen po ia u japi familjes t'tij për m'u miqasu, për me vazhdu

<sup>2</sup> Fjalë e vjetër shqipe, çantat anash shalës së kalit. Përveç funksionit praktik, ka pasur edhe funksion estetik, *duqi* (sh.) zakonisht është punuar me *vek* dhe është qëndisur bukur me motive tradicionale.

miqasinë. Kur jonë shku te familja A edhe i kanë thonë të zotit t’shpisë, “Urime, ta ka falë gjakun”. Edhe për me shku miqasia, për me qenë komplet, një vajzë t’tij, n’atë kohë ka qenë cila ka qenë n’rend, ia ka dhanë djalit tond. Ky menon i zoti i shpisë edhe thotë, “Jo faleminderës, thuj. Nuk e pranoj me ma falë gjakun me miqasi.” “Pse s’e pranon?” Thotë, “Se kështu, nëse nuk ma falë gjakun, ma vret një mashkull. E nëse një rob...” atëhere o qujtë, “nëse ni femër jo e mirë, hyn në familje ma shkatërron krejt familjen.” “Tash,” thotë, “ma llogari kom me ma vra një mashkull se sa me ma shkatërru familjen”.

Domethanë njerëzt n’atë kohë, aq shumë e kanë çmu familjen sa nuk kanë pranë as gjaku me iu falë, e mos m’u miqasu me... po dhashtë Zoti, se sot osht’ vështirë me i tregu rinisë randësinë e familjes. Zakonisht po thojnë, “Jo me randësi osht’ djali e vajza” e unë mendoj që prapë... unë jom me t’vjetrat, randësia e familjes osht’ e padiskutushme edhe duhemi n’çdo moment me i kqyrë familjet. Pse i kqyrin edhe n’Amerikë, edhe n’Gjermani edhe gjithkund i kqyrin. Ju i dini rregullat, jo rastësisht familjet mbretërore nuk guxon me marrë gjithëkond, po tek ne pak po ndryshojnë kohët edhe...

**Jeta Rexha:** Po kthehemi tash te ju, në shkollën e mesme, çka ka qenë noj aktivitet tjetër që keni bo përveç msimit?

**Riza Krasniqi:** T’ju them të drejtën, jom konë tash...nuk di si i thoni ju, na në atë kohë i thojshim *bubaq*<sup>3</sup>, njeri që veç mëson. Edhe shumicën e kohës veç kom mësu. Nuk kom pasë ndonji aktivitet kështu që me thanë pa... edhe çka, dilshim me lujtë me top te shkolla, aty e kem pasë kënaqësinë ma t’madhe. Me shku me kqyrë futboll kur lujshin, noj ditë tjetër që me lexu, po jo shumë, ma pak kemi lexu edhe n’atë kohë, po jo sa duhet.

**Jeta Rexha:** Ku keni qenë në ’81-tën?

**Riza Krasniqi:** Në ’81-tën kam qenë si... viti i katërt, student i Elektros. Edhe une kom jetu te motra, nuk kom jetu n’konvikt të studentave kështu që kurrë as nuk jam ushqy në konvikt të studentave. Kështu që nuk e di atë ngjarjen qysh kanë fillu protestat, kush e ka organizu. Nuk jom konë as n’atë grupin e organizatorëve, as nuk e di qysh, ku kanë dalë studentat tjerë, kom dalë mas tyne, por jo që kom pasë noj rol në ato lëvizje.

**Jeta Rexha:** Jeta n’fakulltet... se devijum pak.

**Riza Krasniqi:** Jeta n’fakulltet, jetë normale e studentit. Tash jetë normale sa mund të konsiderohet jetë normale. Kom jetu te motra, me shokë çka kem pasë atëhere kënaqësi me shku ndonjiherë noj film me pa. Edhe atëherë ka qenë ni kafe “Beograd”, shkojshim ndonjiherë me pi nga një, me dalë me shëtitë me studenta. N’atë kohë e kem pasë korzon, si kënaqësinë ma t’madhe n’jetë, me dalë me shiqu n’korzo. Pasi na n’Elektro jemi konë t’gjithë djem, veç një vajzë. Na ka mungu shoqëria, edhe kur delshim n’korzo, kqyrshim ma shumë vajza. Bile, tash m’kujtohet ni profesor i cili i bonte dy metoda të analizës të ujit, metoda e La Granshit<sup>4</sup> dhe metoda e Ujlerit<sup>5</sup>, kjo m’kujtohet. Por kurrë s’e kuptojshim

<sup>3</sup> Serbisht: *bubaq*, që mëson shumë.

<sup>4</sup> Origjinali: *LaGragne Method*.

<sup>5</sup> Origjinali: *Euler Method*.

mirë, se i harrojshim ato. Metoda e La Granshit ka qenë kur ulesh n'urë për shembull edhe analizon tërë sasinë e ujit e cila rrjedhë. Metoda e Ujlerit o konë, thojke, "E merr ni anije ose diçka, ose afër krejt ecë edhe e analizon nji sasi të ujit vetëm, ndryshimet e saj". Për shembull, në nji kilometër e analizon nji sasi t'ujit. Neve studentave na u përzijke n'atë kohë. Nji herë profesori tha, "Qe për me mbajtë n'mend, kur t'delni n'korzë," pasi ishim kryesisht djemë pothuajse, "ju thamë, mashkujt ma s'pari e zbatoni metodën e La Granshit, ndaleni në një vend edhe i kqyrni krejt vajzat që kalojnë. Ma vonë e zbatoni metodën e Ujlerit, e ndalni ni vajzë që ju pëlqen edhe veç me to shkoni. Nuk ju intereson mo sasia tjetër".

Domethonë kjo ka qenë nji zbatim praktik i...(qeshë). Mund t'ju duket qesharake, se s'ka boll mend studentit (qeshë) dhe me siguri t'mos na kish spjegu për korzë, metodën e La Granshit dhe Ujlerit, kurrë s'e kisha mbajtë n'mend.

**Erëmirë Krasniqi:** Tregona pak për n'Pejë, kur jeni kthi n'Pejë?

**Riza Krasniqi:** Jom kthi në 1982 se baba nuk m'la me marrë banesë, "Me kon don me jetu une këtu, veç me nanën tonde a?" Edhe fillova rastësisht me punu si profesor në gjimnazin e Pejës.

**Erëmirë Krasniqi:** N'cilin vit?

**Riza Krasniqi:** Deri n'vitin 1999 kom punu si profesor i informatikës edhe ktu veç fillojnë ato... tash t'themi, populli jonë vazhdimisht ka vujtë po jonë do etapa kur ka vujtë ma shumë. Mas '81-tës filloi situata m'u ashpërsu. Serbia i murrë... n'atë kohë realisht ka fillu ato vujtjet jo reale, se vujtjet po, deshte s'deshte ta kanë imponu me u marrë me politikë. N'atë kohë m'kujtohet mledhjet për çdo natë u deshke deri vonë mledhjet e Komitetit të Qendror të Kosovës, mledhjet e Komitetit Qendror të Serbisë, mledhjet e Komitetit Qendror të Jugosllavisë edhe çdo ditë situata vinte t'u u ashpërsu. Fillunë diferencimet, fillunë me i largu njerëzt prej pune, edhe ish pak vështirë mos me u marrë me politikë. Sado që ne si inxhinierë i kishim mësu që për me zhvillu popullin duhet sa ma pak... mos me u marrë me politikë, me u marrë me shkencë. Po, erdh ni kohë pak jo... deshte s'deshte u deshtë me u marrë me politikë se [në] mledhjet e Lidhjes Komuniste çdo ditë ndodhke diçka, me shkru parolla, "Kosova Republikë", e ka qenë situatë bukur e vështirë. Po situatë e cila t'themi realisht vetëm mund t'përjetohet e vështirë të s'kjarohet. Tash me i thanë dikujt që na u deshke me u rujtë n'atë kohë me gjimnaz mos me shkrujtë dikush "KR". Se me shkrujtë dikush "KR", u deshke mledhje ni javë me mbajtë, kush e ka shkru, me denu pse e ka shkru.

Tash, n'kontekstin e sotit i duket dikuj e palogjikshme kur për shembull, nji nxanës një here e kish vizatu Skënderbeun në dërrasë t'zezë. Edhe erdhën menihere Komiteti me majtë mledhjen me përjashtu atë nxanës. Pse more me përjashtu nxanësin? "Jo nuk bon, jo..." Edhe u ndamë siç ndaheshim n'atë kohë, të gjithë shqiptarët ishim për me ia dhonë parapërjashtim atij nxanësit se e kish vizatu Skënderbeun. Të gjithë serbët ishin për me përjashtu. Njeni, ni shqiptar në atë kohë votoi për me përjashtu. Edhe ne t'gjithë... "Çka ka bo, pse e ka vizatu Skënderbeun?" Ai ishte ni demagog i llojit t'vetë i cili mas mledhjes tha, "Jo..." "Pse votove me e përjashtu?" "Sepse e ka nënçmu Skënderbeun,

se Skënderbeu nuk e ka vendin n'dërrasë t'zezë." Domethanë, çdo herë, edhe n'atë kohë edhe n'mesin e profesorëve ka pasë disa njerëz që nuk kanë punu për kombin ashtu siç duhet.

**Erëmirë Krasniqi:** Kjo kur keni punu si profesor?

**Riza Krasniqi:** Profesor, profesor... s'e di n'mledhje kur i tha, "Qysh bre burrë votove për m'u përjashtu? Po çka ka bo nxanësi? Pse e ka vizatu Skënderbeun, heroin kombëtar?" "Jo," tha, "Skënderbeu s'e ka vendin aty, për qata kom votu për me e përjashtu." Domethonë, jonë do kohna pak ma t'vështira që... se çdo ditë vijke situata që tu u ashpërsu. Pastaj, Serbia i heki edhe do t'drejta që i kem pasë n'atë kohë, filloi greva e minatorëve, protesta çdo ditë n'Pejë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ju kanë përjashtu prej shkollës ose a keni pasë naj presion kur fillunë qito ndryshime politike?

**Riza Krasniqi:** Po shiqo...

**Erëmirë Krasniqi:** A e mbyllën shkollën e mesme?

**Riza Krasniqi:** Jo, gjimnazin deri n'vitin 1990 nuk e kanë mbyllë. Kur i kanë mbyllë... atë presion, presion ishte se thojshin me i pranu planprograme e Serbisë. Po na n'atë kohë askush nuk dyshonte që duhet me i pranu ato planprograme, se n'ato planprograme Serbia nuk ishte okupatore n'Kosovë, po ishte çlirimtare e Kosovës. Domethanë, kur ka ardhë në 1992-tën, ti u deshe simbas planprogramit të tyre me iu thanë që Serbia e ka çliru Kosovën. E shumë e shumë nonsense të tjera që koka normale nuk i...pranon. Prandaj ne nuk i pranumë ato, edhe mas të '90-tës dihet fillumë nëpër shtëpia. Osht' ni çmim që realisht osht' shumë i madh që na u ka deshtë me e pagu se s'i kem pranu ato planprograme. Pse megjithatë shtëpi-shkollë ne i kem thanë, po mësimi osht' zhvillu në kushte jo normale.

**Erëmirë Krasniqi:** Cili vit? Prej '90-tës e tutje?

**Riza Krasniqi:** Prej '90-tës e tutje kur kemi fillu me shtëpi-shkollë. E n'gjimnaz n'atë kohë po them çdo mledhje e partisë ka qenë dhunim në mënyrën e vetë, presion. Dojshin me na bindë, si profesorë si intelektualë, ju me i pranu ndryshimet kushtetuse në të cilën Kosova i humbte disa të drejta elementare. Edhe, edhe thojke "Pranoji se nuk po humbë kurgjo Kosova". Dojke edhe me t'bo budallë, edhe me t'thonë, "Këta vetë kanë votu". Çka po thojnë për neve n'atë kohë ishte e pa... po, noshta situatën ma t'mirë n'atë kohë, une e kom ndëgju prej... ma s'mirti e ka çmu një doktor shkence ka qenë, ni i Sllovenisë. Me ni emision slloven, e pytën, "Kur e ki pa ti që Jugosllavia ka qenë në krizë?" edhe ai po thotë, "Kur unë jom pranu me ni koleg doktor shkence, cili prej neve do të pranohet ka vendosë vota e ni pastrusi" se përpara ka qenë Këshilli i Punëtorëve. Në Këshill të Punëtorëve osht' deshtë me pasë ni pastrus. "Kur ni pastrus" thojke "vendosë ni doktor shkence duhet me u pranu, ajo shoqëri nuk ka ardhmëri". Une edhe shpesh sot e përmendi. Kur ni pastrus, ni i pashkollë i merr meritat të cilat nuk i takojnë edhe vendosë për fatin e ni doktori t'shkencës ose për fatin e një akademikut, ajo shoqëri nuk ka...



Edhe n'atë kohë, vijke mos t'them tash, ni pastrus ose ni prej Beogradit që s'di a dike me lexu edhe n'emën të Lidhjes Komuniste na mbajke fjalim. Prandaj, edhe sot duhet me pasë kujdes n'këtë aspekt. Nuk duhet me leju që n'emër të asnji partie, me ardhë një pastrus... po them kështu pa e ofendu, po jo ni pastrus me vendosë për ni akademik, se ajo shoqëri, ni i pashkollë t'them me vendosë për ni akademik, se ajo shoqëri nuk ka ardhmëri.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ju qitën prej shkollës, a u murrë naj vendim? Qysh ndodhi ai procesi i largimit prej ndërtesave?

**Riza Krasniqi:** Po, osht' interesant pak se...ndoshta njeriu mendon shumë herë qysh i konvenon. Vitin e fundit që e kem bo n'gjimnaz në 1989-tën, '90 edhe vitin e fundit kem punu... se përpara n'gjimnaz o punu viti i parë dhe i katërt paradite, si shqiptarët si serbët, viti i dytë e i tretë pasdite. Vitin e fundit serbët thanë, "Jo, na po frigothem", po krejt serbët kanë me dalë paradite edhe viti i katërt paradite, shqiptarët. Domethanë, viti i parë, dytë, tretë, katërt {numron në gishta} serbët paradite, edhe viti i katërt shqiptarët paradite. Pasdite, viti i parë, dytë, tretë shqiptarë. Edhe tash ata ndikohen, n'fund t'qershorit dulën me proklamata serbët. Edhe kur shkumë na me 1 shtator, nuk na lejunë me u kyçë. Ishte policia përpara, bile aty kanë marrë edhe profesorë, kanë çu n'burg se për ata që nuk i pranojnë programet e Serbisë, nuk ka vend n'ato shkolla. E ne pastaj kem fillu aksionin që çdo familje që e kish ni nxanës, u deshte me rezervu ni ditë shtëpinë-shkollë. Po ajo i ka pasë shumë probleme se m'kujtohet si sot për shembull ndoshta ishin dy shoqe në t'njejtën bankë, kur shkojshe te njena, e shihshe që bukë s'ka me hangër. T'nesërmit u deshke me shku te tjetra, kish kushte jashtëzakonisht t'mira.

E pranoj shumë vështirë tash, prej ni shpije t'tillë me shku te ni tjetër, ose mu si profesor, m'kujtohet për shembull që i kisha gjashtë orë mrenda dite edhe u deshke orën e parë me e mbajtë t'themi n'këtë lagje. Orën e dytë e kisha krejt dikah tjetër u deshke ni nxanës me dalë me m'tregu n'cilën shpi po majnë mësim. Orën e tretë krejt dikah tjetër edhe tërë kohën ishe i kërcënuar që mundet me t'rrehë policia, se ishte simbas tyne ilegale me mbajtë mësimin. Bile, m'kujtohet nihere ni prind... se edhe prindët nganjihere nuk ia qëllojnë po kur u kry ora e gjashtë, isha te ai n'mësim. "Eh profesor hajde se du me t'qarrosë ni kafe, du se..." "E pse?" Tha, "U gëzova që e heka dertin tash edhe ni mujë ditë nuk i kom mo fëmitë n'shpi teme, se gjithë natën s'më ka marrë gjumi mos po vjen policia me na rrahë". Thashë, "Po zotni ti e ki hekë dertin për ni mujë, po unë prapë nesër i kom gjashtë orë. Prapë masnesër, këtë dert tondin që e ke pasë, une e kom çdo ditë". Edhe na çdo ditë jem shku, tash me frigë. Friga ka qenë normale se secilido polic serb ka mujtë midis rrugës... se Peja qytet i vogël, shumica na kanë njoftë. Na kanë njoftë, t'kanë njoftë që je profesor. Edhe me t'rrehë e me t'burgosë, me ba çka kanë pasë dëshirë. Po, osht' çmim që o deshtë me pagu. E kem pagu shtrejtë se fatkeqësisht n'atë kohë na ma shumë jem shku ndoshta për me vazhdu mësimin për me thanë, për mos me lanë krejt atë masë se sa dituria që o marrë, nuk ka mujtë me qenë në nivel.

Nuk kom mujtë unë informatikën kërkun me spjegu në një odë ku e kom pasë veç një shkumës, edhe pa dërrasë t'zezë. Qysh dojsa une me sqaru informatikën se n'atë kohë e kom pasë dosjen e do rregulla, komandën dir, shkruje kështu, dir kështu. Kompjuteri nuk e ka ashtu, informatika. Tash paramendoni

qysh keni me ia shpjegu dikujt window-sin pa pasë kompjuter, pa pasë...ose si me thanë si ia skjaroni dikuj si punohet me telefon nëse s'ka telefon e s'din çka o telefoni. Ama edhe sistemi jonë i arsimit n'atë kohë ka pësu jashtëzakonisht shumë, por po them osht' çmim që o deshtë me pagu se s'ke pasë tjetër zgjedhje.

**Erëmirë Krasniqi:** Sa t'ngarkumë politikisht i ke pasë studentat? Për shembull a e nijsin ata që të presion politik tonë kohën t'u i pasë... që u dashin me u zhvendosë prej shpisë n'shpi. A i ka revoltu kjo studentat e jujë n'atë kohë? Qysh i ka afektu ata?

**Riza Krasniqi:** Normal që nxanësi ka afektu. Normal... edhe... osht' n'atë kohë edhe tash prej juve me ju thanë që kom pasë nxanëse Myrvete Dreshën, Have Shalën që moshën 18 vjeçare n'burg e kanë festu. Pa i bo 18 vjet ato jonë burgosë, se njeriu... si nxanëse të gjimnazit.

**Erëmirë Krasniqi:** Për çfarë arsye?

**Riza Krasniqi:** Politike, politike... se kanë t'drejtat e shqiptarëve, kanë kërku "Kosova Republikë", kanë formu organizata t'rinisë. Edhe pse sa mundet me punu rinia dihet n'atë kohë, po domosdoshmëria me kontribu për kombin ka qenë shumë ma e madhe se sa realiteti, se vetëdija e tyne e lartë n'atë kohë që duhet t'bjmë diçka që të çlirohemi, ka dominu mbi t'themi, realitetin. Realisht, fuqia e tyne nuk ka qenë shumë e madhe, po dëshira ka qenë shumë e madhe. Edhe jo veç n'Pejë po edhe n'atë kohë, për shembull, për çdo ditë ke pasë protesta. Ajo përkrahja e minatorëve ka qenë madhështore. Edhe tash, kur je viktimë e politikës, kur te din se krejt shokët e shoqet tua n'Evropë shkojnë nëpër shkolla normale. Kur t'i sheh kojshinë e parë që e ki serbë, që shkon n'shkollë normale. Kurse ti duhesh... sot nuk e din ku mbahet mësimi, ti deshte s'deshte s'ke qare pa u marrë me politikë. Politika t'imponohet... se je viktimë. E nëse ti si viktimë nuk reagon, kush do t'reagon n'emën tandin.

Prandaj nxanësit n'atë kohë jonë marrë shumë ma shumë me politikë t'themi... se sa maturantat e sodit ose rinia e sodit, sepse nuk kanë pasë tjetër rrugëdalje. Jonë me dhjetëra t'burgosun t'gjimnazit t'Pejës që unë ju kom dhanë mësim... për çashtje kombëtare. E tash paramendoni një 17, 18 vjeçare n'atë kohë me hy n'burg edhe me t'malltretu në mënyra t'ndryshme, pasojat edhe sot i vujnë. Me shëndet shumica prej tyne kanë pasoja të tjera të burgut. [I drejtohet intervistuesëve] Pytni krejt çka ju intereson se tash diçka fshijmë, diçka hekim, diçka... apo provokoni ka pak, ngucni ka pak. Mos...

Për ju osht' pak ma vështirë se s'i keni përjetu ato shumë. A din, osht' ma... që osht' me i thanë dikujt që osht' 17 vjeçare, hi n'burg, Kosova Republikë, se ata andërr e kanë pasë. Sot rinia mendon pak ma ndryshe.

**Erëmirë Krasniqi:** E çka ndodhi më pas, a gjetet ndonji objekt permanent?

**Riza Krasniqi:** Jo...pastaj m'u dha aty prej bashkësive lokale. Ka pasë ndonji bashkësi lokale që e ka gjetë një objekt permanent. Ka pasë bashkësi lokale të cilat kurrë s'e kanë gjetë atë... por çdo ditë e kanë ndërru për tetë vite, i kanë ndërru vendet, shtëpiat.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh u përfshitë ju në pajtime? A mundeni me na tregu qysh jeni përfshi, kush iu ka ftu edhe qysh kanë rrjedh gjanat në atë periudhë?

**Riza Krasniqi:** Po tash, pikërisht në fund t'janarit, me 10 shkurt bahën 26 vite që ka ndodhë takimi i parë n'Raushiq te familja Buçolli. Diku ni javë përpara, do t'thotë qësi kohe para 26 vitesh, ka ardhë Flamur Gashi ni ish-nxanës i imi, ish i burgosun<sup>6</sup>, tash osht' këshilltar i presidentit Nishani në Shqipëri. Edhe tha, "Profesor, e kemi fillu lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve, studentët, edhe a don me na u bashkangjitë, ma s'pari?" Thashë "Po". E disha plagën e pajtimeve, e di sa vujnë njerëzit, e kom ditë se tregojshin njerëzit edhe përpara sa vështirë osht' me qenë në gjak. "Edhe e dyta," tha, "na duhet me formu ekipin e intelektualëve të Pejës." Thashë, "E formojmë". Na u deshke me gjetë njerëz që kanë reputacion, që i njef populli, që i çmon populli.

Në natën e 9 shkurtit kom ardhë me Flamurin në Prishtinë edhe me 10 shkurt në mëngjes, kem shku te profesor Zekerija Cana. Profesor Zekerija Cana nuk ishte në shtëpi, se atë ditë i kishte vdekë vëllau i profesor Ymer Jakës. Bile m'kujtohet nana e tij, Magbule e ka pasë, nana e profesor Zekerija Canës, tha, "A mundeni ju djemtë e mi me m'çu tash aty ku ka vdekë..." s'e dijsim na adresën. Thamë, "Po. Ku jeton?" Përafërsisht e dije, Dragodan, po s'dijke... e tash u dashke me ndalë makinën rrugës e me i pytë njerëzit. Shumica nuk e dijsin edhe plaka u bojke nervoz, "Na n'Gjakovë krejt e dijmë ku e kanë shpinë njoni-tjetri. E këtu marre për juve, marre mos me ditë ku o..." Menxi e gjetëm (buzëqeshë), pastaj shkumë n'shpi te profesor Anton Çetta.

Profesor Antoni ish konë t'u na pritë te dera se i ishte frigu policisë. Vjen masanej ajo tuta prej milicisë mas... me iu tregu jo, po kështu kishte ndodhë. Tha, "Kon me e thirrë tash?" Unë s'i njifsha fort intelektualët e Prishtinës, ma shumë i njifsha profesorët... ai e ka thirrë n'atë kohë presidentin Rugova, n'atë kohë ka qenë kryetar vetëm i LDK-së, se Lidhja Demokratike osht' themelu n'dhjetor, domethanë kjo ka ndodhë në janar. Po profesor Çetta na tregoi që "Rugova," tha, "e ka telefonin nxanun krejt kohën." "Kon me e thirrë?" Tha, "P'e thirim profesor Ramiz Kelmendin." E kem thirrë profesor Ramiz Kelmendin, shkrimtarin, "Po." Tha. Kem shku e kem marrë edhe kem vazhdu për Pejë. Rrugës ka pytë, "Rizë me kon je n'gjak?" E i kom tregu që kjo osht' një lëvizje e rinisë që Riza nuk o n'gjak me kërkon, po rinia e ka fillu.

Edhe prej atyhit kemi shku në... na kanë pritë shokët e shoqet n'Pejë. Profesor Nimon Ali Musa ka qenë prej gjimnazit, kolegë që kem punu n'gjuhën shqipe. Have Shala, Myrvete Dreshaj, Adem Grabovci, Ibrahim Dreshaj... ka qenë një grup i t'rinjëve. Tash m'kujtohen edhe emrat tjerë, Nurie Zekaj edhe disa... edhe jem shku, ma s'pari m'kanë thanë osht' mirë me pa, me shku me pa, se ka vdekë ni i burgosun i *Goli Otok-ut*<sup>7</sup>. I burgosuni i *Goli Otokut* n'atë kohë, *Goli Otok* ka qenë burgu ma famëkeq ku kanë shku shqiptarët. Edhe ni patriot i... profesor Antoni tha, "Po, po shkojmë", para se me shku me

<sup>6</sup> I intervistuari ndoshta i përzinë biografitë e studentëve të tij. Flamur Gashi nuk ka qenë i burgosur politik, por Hava Shala, Myrvete Dreshaj etj.

<sup>7</sup> Ishull në veri të detit Adriatik, që nga viti 1949 deri 1956 ka qenë koloni e të burgosurve politik të Jugosllavisë, ku individit akuzohej për simpati ndaj Bashkimit Sovjetik apo të tjerë, shumë prej tyre ishin shqiptarë të burgosur për arsye tjera. Njihet si një gulag i vërtetë.

kërku me na falë gjakun. Kur shkumë atje, tash mundeni me marrë me mend. Profesor Antoni ishte n'mes, Ramiz Kelmendi ishte në krah t'majtë, une isha n'krah t'djathtë, edhe krejt tjerët ishin nxanësa e studenta.

Ni plakut nuk ia mbushi synin, mendjen, kështu profesor Antoni, e i thotë, “Profesor, jemi mësu ti me na ardhë me do burra me pa, e jo, na paske ardhë me fëmi”. E profesor Antoni p'i tregon tona se... profesor Antoni i ka pasë shumë veti t'mira, burrënore. Por, një është që dije tregimet popullore ku me i tregu, ka dijtë shumë, edhe çdo herë ... tregimet popullore, osht' me randësi aq sa din, qaq osht' me randësi edhe me dijtë ku me i vendosë. E po tregon profesor Antoni tha, “Paska vdekë një mbret një kohë, edhe paska lonë një djalë t'moshës jo madhore për me u ba mbret. Edhe kur o mbledhë pleqnia, kanë vendosë që jo djalin e vetë me e lanë mbret, po me lanë mbret dikon tjetër. Edhe jonë shku e ia kanë komunikë djalit t'vetë. Djali i vetë ka thonë, ‘Ani n'rregull, a bon qët' vendim... a bon t'shtunën?’ Ishte ditë pazari, ‘A bon t'shtunën me komunikë?’ Ky i thotë, ‘Po, edhe mblidhen krejt populli. Ky djali i mbretit paska shku edhe paska marrë një pulë edhe do shota t'vogla. Edhe e merr e gjunë pulën n'ujë, pula s'din me notu. I gjunë shotat e vogla, edhe shotat t'gjitha notojnë. Edhe populli e merr porosinë që nuk varet prej moshës, por varet sa intelgjent je, sa natyra ta ka dhonë, edhe e lojnë këtë djalin mbret.” Edhe tha, “Mos e kqyr moshën e ktyne të rijve, se këta e kanë nisë lëvizjen ma t'dobishme t'popullit e cila ka ndodhë te na. Pikërisht kjo rini e ka fillu lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve. Na prej ktuhit kemi shku n'Lumbardh, kemi shku n'Raushiq. Kjo rini osht' t'u e ba një punë madhështore të cilën na u deshtë me bo. Por, na s'e bamë, e po e bajnë këta.”

Edhe ashtu, prej aty shkumë në Lumbardh. Në Lumbardh na dhanë tre mujë besë. Prej atyhit shkumë n'Raushiq, n'Raushiq ishte ni problem shumë i madh, mirëpo u morrën vesh ata që me ndodhë pajtimi. Edhe karakteristika për Raushiq osht' që pajtimi osht' ba me Kur'an. Edhe, m'tregoi ky profesor Nimoni kur ka shku te hoxha i Strellcit me lypë një Kur'an se do t'ndodhë, hoxha i Strellcit ia ka dhanë Mulla Ramadanit, ia ka dhanë Kur'anin n'shqip, thotë, “Se puna me ju shku shqip, jo arabisht.” Edhe... rastësia, puna na ka shku, pikërisht shqip, n'krejt Lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve. Po, çka osht' ma me randësi edhe ma vonë, kur vijshin gazetarët e hujë, edhe zakonisht pytshin për pajtime, po ishte shumë vështirë me iu skjaru Anton Çetta edhe Kur'ani. Anton Çetta shqiptar i besimit të krishter, Kur'ani, dihet libri i shejtë musliman, thojke, “Çka kanë këta t'përbashkët?” Edhe ne shumë herë kemi pasë probleme me ua sqaru të hujëve harmoninë tonë fetare.

Mu m'kujtohet një rast që kur t'flasim për pajtimin e gjaqeve, Pajtimi i Gjaqeve osht' Lëvizja ma ideale që ka ndodhë te ne. I ka pasë disa shtylla shumë t'fuqishme. Nji ndër shtyllat kryesore ka qenë ndershmëria {numron në gishta}. Pse thomë ndershmëria? Anton Çetta ka vdekë i varfër, mu m'vjen keq me thanë, po ka vdekë i varfër. Jonë pajtu ma shumë se nji mijë gjaqe. Ni markë ta kish marrë n'atë kohë Anton Çetta, por kurrë paraja nuk osht' përmend, prandaj osht' nji lëvizje shumë e ndershme. Rrallë ndodhë që udhëheqësit e çfarëdo lëvizje, çfarëdo qoftë ato, të vdesin të varfër, siç ka vdekë profesor Antoni. Harmonia fetare, një ndër shtyllat e kësaj lëvizjes, jo rastësisht thashë, “Ku'rani dhe profesor Antoni”.

Une e di me një rast, ishin prej Belgjikës dy gazetarë, e ishin ardhë në Rrafsh të Dukagjinit. Atë ditë profesor Antoni s'ish ardhë me neve, por ishte profesor Marku. Edhe ata gazetarët krejt ditën me neve, veç ndëgjoishin e inçizojshin. Në mbramje isha ngatë profesor Markut, edhe p'e pysin profesorin, "Profesor," tha, "na pamë pajtimin e gjakut, por po na intereson edhe relacionet fetare te ju shqiptarët, sepse Serbia krejt kohën thotë që këta do ta ndërtojnë një shtet mysliman. Sa ka realitet aty? Sa jonë shqiptarët të besimit krishterë të diskriminimë? Edhe a jeni të diskriminimë?" Tha, "Po, jom i diskriminimë" "A bon një rast?" "Po," thotë, "sot, ku gjithë ditën keni qenë me neve, ka pasë doktor shkence, profesorë, intelektualë n'atë..." qysh na qujshin neve, 'krushqit e pajtimit'. "Të gjithë janë muslimanë, një osht' katolik. Q'ai katolik jom une, une ju prij të gjithëve. A ka noj anë tjetër n'botë ku ni katolik i prin edhe hoxhës edhe intelektualëve edhe t'gjithëve". E tha ajo gazetarja, "Profesor, mirë kjo mundet me qenë rastësi." "Mirë nëse osht' kjo rastësi, masi e çoj une, ose nëse shkoni sot kah Drenica, atje profesor Antoni udhëheqë, profesor Anton Çetta. Edhe ai osht' shqiptar i besimit krishter, kurse 99 përqind e gjithë që jonë mas tij janë muslimanë. A mundet me qenë edhe kjo ratësi?" "Jo," tha, "kjo s'mundet me qenë rastësi." "A mundet me qenë rastësi tjetra," profesor Marku p'i thotë, "që heronjë kombëtar tek ne jonë Nënë Tereza dhe Gjergj Kastrioti, asnjoni s'o musliman? Nuk e ke ni komb n'botë ku dihet përbërja, shumica janë muslimanë kurse herojtë kombëtarë janë të besimit krishterë. A ki dikah tjetër n'botë?" Tha, "Jo." Sepse, profesor Marku kur u bojke nervoz, vazhdojke me kësi raste. "A ke ti raste n'botë?" Ai e tregojke një fshat n'atë anë. Tha, "Kqyre, kur osht' ardhë koha e Ramazanit, se n'Ramazan osht' iftari dhe syfyri kur duhet me lajmru populin. Prifti ia ka dhanë çelësin e kishës një plakut musliman që ai osht' shku çdo herë me anë t'kishës, me anë t'kambanave t'kishës i ka lajmru shqiptarët e besimit musliman që qitash osht' iftari, qitash osht' syfyri". Krejt kësi raste ka tregu. "A po e kupton tash harmoninë fetare në shqiptarë?" Edhe gazetarët kanë mbetë pa fjalë.

Do t' thotë harmonia fetare ka qenë ndër shtyllat kryesore t'Lëvizjes për Pajtime të Gjaqeve. Shtylla tjetër kryesore që osht' vazhdimisht e cekun osht' roli i femnës shqiptare. Roli i femnës o konë jashtëzakonisht i madh, edhe pa ndikimin e femnës kurrë Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve as që kish fillu, sepse realisht, Lëvizjen e kanë fillu Hava dhe Myrveti. Ato dyjat jonë t'parat që... te dyjat i kom pasë nxanëse. Edhe te dyjat tregojnë që demonstratat n'Pejë deri n'fund t'janarit, vriten tre demonstruesë. Edhe atë natë ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, del n'televizor dhe deklaroi që sot jonë vra tre shqiptarë n'Pejë, por nuk osht' e vërtetë që i kem vra na si polici. Ata vriten se e ata e kanë gjakmarrjen, e ata e vrasin njoni-tjetrin. Shqiptarët jonë t'u i shfrytëzu protestat për me i pastru hesapet mes veti. Kjo ishte deklarata që e ka shty Havën, Myrveten, pastaj m'duket s'bashku kanë shku n'shpi te Adem Grabovcit, i kanë thirrë edhe shokët tjerë, Flamurin edhe Ibrahimin, Myrveten, Serbeze Vokshin edhe e kanë fillu lëvizjen.

Edhe tjetra, na shumë herë jena mashtru n'fillim që thojke burri, "Nuk e fali gjakun!" Shkojshim n'odë të burrave, sidomos n'fillim, e thojke, "Ky gjak nuk do falet kurrë!" Kanë qenë arsyetimet. Kur dilshim, Bajram Kelmendi avokati i ndërë, i cili ka qenë prej ditëve t'para në Lëvizje thoshte, "Havë, Myrvet, shkoni te gratë se tash filon gruja vendosë këtu, nuk vendosë ky burri me musteqe." E na vijke inati, "Le bre Bajram këto fjalë, nuk vendosë ky?" "Shkoni Havë e Myrvete, ju atje te gratë, edhe ju..." i thojke Hava, Myrvetit, t'nesërmit thojke, "U kry puna, javën tjetër shkojmë pak për me falë." E qe besa u falke

gjaku. Se na ni kohë jetojshim me ato [ide] që burri me musteqe n'sobë t'burrave e falë ose s'pe falë. Realisht, Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve, roli i femrës osht' jashtëzakonisht i madh. Sikurse o deshtë me falë gjakun, sikurse o deshtë me... se kur shkojke pak po them Hava, Myveti, Serbezi, Nuriya edhe bisedojshin me plakun kah dy-tri orë. Ato jonë konë n'gjendje me kajtë para plakut, me ia puthë dorën plakut, me e lutë plakun, se interesi i Kosovës osht' me e falë gjakun.

E tash plaku i vijke keq me e kthy rininë, ka qenë sinqeriteti i rinisë jashtëzakonisht i madh. Edhe pse rinia e ka atë sinqeritet, edhe çdoherë e ka pasë dhe e ka, flas për shumicën. Edhe atëhere, edhe tash çdo herë edhe n'mesin e rinisë, del dikush jo i sinqertë. Po kur flasim për shumicën, shumica e rinisë e kanë atë sinqeritet. T'them të drejtën, kur osht' dashtë femna me falë, ka qenë pak ma vështirë. Jonë kriju do situata pak ma... m'kujtohet rasti i një... Besa, e ka pasë emrin edhe shkumë në ni fshat, vëllaun e kishte mësues, erdh vëllaun n'odë t'burrave. Edhe tha, "Duhet..." babën ia kishin mbyttë, "A bon," tha, "une e kom një lutje. E di pse keni ardhë." "Çfarë lutje ki?" "A bon motra ime Besa me ardhë këtu?" "Po more, pse s'bon". Erdh Besa, u ulë ngat Havës, Myrvetes edhe filloi Besa me folë. "Burra e di pse keni ardhë, e çmoj Lëvizjen e jujë, t'gjitha t'mirat. Mirëpo, a bon me e ndëgju rastin tim." "Po more, pse jo?" "Unë," tha, "jom dalë me babën me punu tokën. Kem shku me kerr-kali n'atë kohë. T'u e punu tokën, kanë ardhë dy kojshi, te dytë e kanë pasë kah ni shati me veti. Edhe tuj folë me babën, kanë fillu me i mëshu babës me shyt", shyt ne i thojmë shumë. "Kur jena afu na, dytë jonë largu. Rrugës për spital t'u e çu babën me kerr-kali, baba ma ka lypë besën, ka thanë, 'Ama besën e shqiptarit, që nëse m'ndodhë diçka, nuk e fal gjakun'. Babës ia kom dhanë besën e shqiptarit," thojke. "A muj une tash me falë gjakun? Baba ka vdekë n'spital prej plagëve t'marruna." Bile, e tha në një mënyrë, "A mundet Besa me shkelë besën?" Çka me i thanë? Domethonë, kërkush prej neve nuk mujshim me i thanë, "Jo valla, çohu se..." M'duket profesor Ramizi tha, "Në rregull, po t'kuptojmë Besa. A e bon ti një punë tjetër për neve?" "Urrno profesor?" "A po vjen me neve sot me na ndihmu me falë raste t'tjera? Bonu pjesë e krushqve t'pajtimit". Edhe Besa pranoi, "Per ate jom n'gjendje çdo gja me ba, po mos kërkoni me e thy besën shqiptare." Edhe atë ditë, t'nesërit, prapë ishte me neve. Dikun masdite kah ora dy, ishim n'kerr me mu, me profesor Ramizin edhe profesor Antonin. Tha, "Burra, a t'shkojmë n'shpi kah une?" U pa që ka vendosë me falë. Edhe ne e ndërrumë planin, ishte shumë me randësi me u falë ai gjak, edhe rrugës t'u shku kërkoi me u ndalë te vorret. Kur u ndal te vorret, dul prej kerrit edhe vazhdoi kah vorri po u shihke pak si e trullume.

## Pjesa e Dytë

**Riza Krasniqi:** Diku pasdite të dielen kjo Besa kërkoi me shku... tha, "Po shkojmë në familje te unë." E pamë që ka vendos me fal, e ndërrumë orarin edhe t'u shku n'moment kërkoi tha, "A bon me u ndalë te vorret?" E ndalëm, edhe kur shkoi te vorri i babës, shkova unë me profesorin, i'u afrumë edhe e zhvilloi një dialog mjaft të vështirë. Babë tha, "Ti e din që une ta kom dhanë besën, çdo here," tha, "m'ke thonë me majtë besën edhe emrin ma ke dhon Besë. Po sot po ndryshojnë kohënat, rinia e Kosovës po lypë me u falë gjaku yt, interesi i Kosovës po lypë me u falë gjaku yt. Ti vazhën besnike e ke, edhe besnike do ta kesh tonë jetën. Po interesi i Kosovës koka ma i madh se besa e dhanun, prandaj babë... boma hallall se mu sot... m'duhet me e falë gjakun".

Filloi Besa me qajtë te vorri i babës, fillumë edhe na... por ma pas pak orësh, shkumë edhe e fali gjakun. Kurrë ma Besën s'e kom pa, nuk e di çka ka ndodhë me atë femër... por jo Besa, por të gjitha gjaqet që jonë falë, jonë falë për ardhmërinë e Kosovës... për një Kosovë, për një shtet të mirë... për një Kosovë të cilët t'gjithë e kem ëndrruar ma t'mirë se sa që sot e kemi. Edhe gjaqet, ka me qindra raste që jonë falë dhe që të gjitha gjaqet jonë falë për rininë e Kosovës, për ardhmërinë. Nuk jonë falë as për ndonjë parti, as për ndonjë qëllim tjetër.

*[Intervisuesja kërkon nga folësi të flet më detajshëm rreth rolit të gruas në Lëvizjen e Pajtimet të Gjaqeve. Pyetja është prerë nga video intervista.]*

**Riza Krasniqi:** E përmenda që një ndër shtyllat ishte roli i femrës shqiptare, bile tash ne mashkujt na vjen inati pak me thonë (buzëqeshë), po sa herë që s'kemi mujtë n'odë t'burrave me pajtu gjakun, Bajram Kelmendi iu thojke kësaj ekipes t'vazave Havës, Myrvetës, "Shkoni te gratë ju, tash kryni punë atje". Se na kem jetu ne një iluzion që burrat me mustaqe i falin gjaqet, por shpesh herë nuk ishte ashtu. M'kujtohet një rast kur njenës ia kishin vra djalin e vogël, i kishte edhe dy djem. Nuk kishte burrë edhe dy djemtë ishin t'mëdhajë, domethonë diku tridhjetë-tridhjetë e pesë vjeçarë. Edhe kur shkumë n'odë t'burrave, ata dy djemtë, "Na e dijmë pse jeni ardhë, po... edhe na me falë, nana nuk e falë. Nanës ia kanë vra sugarin, nana nuk po pranon kurqysh," Kur na thanë qashtu, thamë, "Ju, a e falni?" Thanë "Na e falim, veç nana le t'thotë." Atëherë disi na u dukë ma e lehtë edhe meniherë Havës, "Shkoni poshtë ju" jo atë ditë, por t'nesërmit, t'masnesrit. Kur kanë shku te nana edhe nana i ka pritë me ato fjalë, "Edhe me falë djemtë, une nuk e fali. E kom pas sugar, e kom deshtë ma s'shumti." "Kjo ishte e pamundur," po tregojnë, "me bindë." Po na tash edhe në ato raste çdo herë kem kërku zgjidhje qysh me... pytëm edhe na tregunë që ajo nanë që ia kishin vra djalin e kishte ni motër me t'cilën kishte raporte shumë t'mira në fshat, po e cila nuk kishte fëmijë... edhe fëmitë e motrës i konsideronte fëmi t'vetë. Pastaj ekipi ka shku te motra... edhe motra n'fillim me ato fjalë [të njejtja], "Edhe djemtë e motrës edhe motra me e falë, une nuk e fali! Se ai djalë u konë i jemi ma shumë se sa i motrës".

E pastaj kanë fillu bisedat edhe n'fund Hava me Myrveten e kanë bindë që duhet me falë, sepse "Nëse nuk falet çka ndodhë? Po supozojmë djali i madh çohet e nxerr gjakun. Ata çohen e vrasin djalin e dytë. Kshtu që, realisht kjo nuk ndërpritet kurrë." Edhe ka thonë, "Ti mbetesh pa tre djem." E falën gjakun, diku mas gjashtë mujve vdiq kjo motra që nuk kishte fëmi, edhe shkumë me vizitu këtë plakën që e kishte falë gjakun, puna e motrës që e dijsim që e kishte deshtë jashtëzakonisht shumë. Edhe u kthy biseda rreth gjakut, ajo na tregoi një detal qe kurrë s'kem mendu përpara për te, ajo tha, "Me tregu t'drejtën, prej asaj dite që është falë gjaku unë po flej rahat. Sa herë që djemtë e mi kanë dalë n'qytet une jom frigu, mos takohen në atë vrasësin, në familjen e tij, mos po e vrasin ate, mos Zoti na rujtë, dikush m'i vret djemtë. Domethonë, unë nuk kom zhvillu jetë normale, nuk kom ditë çka osht' jeta".

Ne shumë herë jemi marrë veç me vuajtjet e familjes së ngjuar. Mirëpo nuk jemi marrë me familjen e cila duhet me nxerrë gjakun, e cila realisht ka qenë viktimë, sepse i vrami ka qenë prej kësaj familjes. Mu m'kujtohet ni rast tjetër që tregon ndoshta ma s'mirti se n'atë kohë, në gjimnaz të Pejës nxanësit e kanë pasë për detyrë, po flas për Pejë e asajde, me ardhë, mu e profesor Nimonit me na i tregu rastet, ku n'cilin fshat ka vrasje, ku ka gjaqe që duhet me u falë. Edhe ne pastaj e kem bo orarin, studentat

kanë punu në mënyrën e vetë, me anë të studentave, edhe t'premtëve u mbledhshim edhe e caktojshim orarin ku po shkojmë nesër. Se t'ju them të drejtën kur na thojshin, "Hajdeni t'shtunën, e t'dillën me profesor Antonin" ne e dijmë që gjaku 90 përqind do të falet. Se puna më e madhe u ba përpara se me ardhë profesor Antoni.

Edhe shkumë me një rast, edhe tregunë që ishte një vrasje, e kishin vra një 30 vjeçarë para pesë vjete. Edhe shkumë, nuk i'a dishim shtëpinë në fshat. E ndala makinën edhe po i shoh dy djemë diku shtatë-tetë vjeçarë ndoshta, jo... n'shkollë s'ka qenë asnjani, domethonë gjashtë-shtatë vjeçarë. Edhe me pushkë t'drunit tu lujtë bam-bam {imiton zhurmën e pushkës}. "Mirëdita, djema!" Ata, "Mirëdita!" "Ku e ka shpinë?" Po i pysisim, tha, "Qikjo osht' shpija." Edhe ne ishim në shtëpinë e qatyne që duhet me e falë gjakun, "E ti çka po bon?" Po e pyses njonin. Tha, "Po e vras Hasanin." "E pse po e vret Hasanin?" Tha, "Se ma ka vra babën, une duhna me nxerrë gjakun. Baba i ka lonë dy djem..." "A je n'shkollë?" "Jo," tha, "po sivjet regjistrohna." Për ni moment ngela t'u mendu, ni fëmi i cili nuk shkon n'shkollë, i cili nuk i din shkronjat, msohet n'shpi qysh duhet me e vra dikun, qysh duhet me nxerrë gjakun. Mund ta paramendoni një familje të tillë, ku për çdo natë flitet qysh duhet me vra vrasësin e babës. Domethonë, në çfarë ambienti rritet ai njeri. Sa famlije të tilla kemi pasë në n'Kosovë, në të cilat është biseduar si të vritet dikush, çka ka ndëgju fëmija në ato familje, "Po dalim nesër po ia nxajmë pritën filanit kshtu ashtu..." Në ato familje nuk është bisedu se qysh duhet me përparu ekonomikisht, qysh fëmija me msu n'shkollë... po qysh me nxerr gjakun, ajo u konë poenta kryesore.

Të themi n'këto familjet tjera, çka u bisedu, n'familjet të cilat kanë qenë t'ngujuara. Në familjet të cilat kanë qenë të ngujuara osht' bisedu kush me punu tokën, qysh me punu tokën, qysh me hangër bukë? Sepse dihet që sipas kanunit në femër nuk është nxerr gjaku. Prandaj femrat e shtëpisë kanë pas t'drejtë me dalë me punu tokën... po dihet fuqia e femrës në atë kohë, çka munet femna me punu n'tokë edhe ne ato kushte. Edhe tash femra, mashkulli s'guxon me dalë... çka mendohet në ato shpi t'ngujuara fëmija s'guxon me shku n'shkollë. Nuk di a mundem me paramendu për ni moment se në çfarë shtate ekzistojnë të dy familjet. Ta paramendojmë familjet e ngujuara nëse dikush, për shembull e ka pasë motrën në atë famlije edhe ky u konë i involvumë në një nifar mënyre ose n'tjetrën. Domethonë, çdo familje e cila n'qoftë ka pasë me nxerrë gjak, qoftë ka qenë i ngjuar, i ka pas edhe pesë-gjashtë famlije tjera përreth të involvuara në atë problem. Kështu që nëse llogarisim numrin e familjeve të involvuara, qoftë në mënyrë direkte, qoftë në mënyrë indirekte, na del jashtëzakonisht i madh. A ka qenë vështirë me falë gjakun? Jashtëzakonisht vështirë ka qenë. Unë atë e kam thënë çdo herë edhe do e përsëris sa t'jom gjallë, që herojtë e vetëm të Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve janë ata që kanë falë gjaqe. Ne të tjerët, ne kemi qenë argatë që kemi vrapu prej një shtëpije në një tjetër, po herojë janë ata që kanë falë gjaqet.

Mu m'kujtohet edhe ni rast mas lufte, një të diele dola me bashkëshortën Shpresën edhe Tringën vajzën e madhe, me shëtitë nëpër qytet. Po e shoh një njeri, po e ngadalëson hapin t'u ardhë ballë për ballë, e njofta. Edhe kur njeri e ngadëalson hapin edhe don me folë, njeriu e heton, u ndala me te. "Mirëdita!" "Mirëdita!" "Çka po boni?" "A po m'njef?" Thashë, "Po. Çka dole sot n'Pejë?" Se n'Pejë, po flas para 15 vitësh, t'dieleve prej fshatërave kanë ardhë ma rrallë. Edhe u shihke njeriu me plis t'bardhë me ato...



tha, “Valla profesor jom ardhë mos p’e shoh najkon t’jujin t’pajtimeve, se jom mërzitë diçka”. Thashë, “Po more qe po ulem, po e pijmë nga një kafe.” I kërkova falje shoqes, i thashë, “Vazhdoni ju me vajzën”.

Kur u ulëm me pi kafe, po m’pytë, “A po m’njef?” Thashë, “Po.” M’tha, “A e din rastin tem?” I thashë, “Po, qysh s’e di rastin.” Edhe po i tregoj që atij ia kanë pas mytë djalin me kmesë n’shkollë filllore, kmesa është ni sakicë e vogël që te na u përdorë n’atë kohë për degë t’pemëve. Edhe ai e ka çu djalin n’shkollë filllore, djali ka bo fjalë me shokë t’bankës, osht’ ardhë dikush i familjes t’djalit [tjetër] edhe me kmesë ia ka mbytë djalin. N’shkollë filllore! Se e di sa kem pa vujtë kur jom shku në parapregaditje të rastit... “Eh, more profesor,” tha, “shoku i bankës t’djalit sot po martohët, atje ka muzikë, ata po hajjnë mish e pite,” popullorqe tha, “djali jem po han dhe. E morra bashkëshorten, grunë, shkumë te vorri, kajtëm sa mujtëm, se s’mujtëm me... tash gruja shkoi te motra e une dola n’qytet me pa dikon prej juve.” Domethonë, një njeri që ka falë, ne e kemi lonë ni kohë t’gjatë me vujtje. Prandaj po them, ata të cilët e kanë falë janë herojë t’vërtetë dhe osht’ turp për shoqërinë tonë që ende sot nuk e kemi ni lapidar, ni permendore të atyre që kanë falë, le të jetë pa emër. Po e atyre që e falën gjakun e ma t’afërmve të tyre për hir të Kosovës që ne të kemi një shtet si duhet. E ky shteti jonë as pas 26 viteve nuk po mundet me ndërte diçka, as ni shtatore të profesor Antonit si bartës të Lëvizjes, as një...quajeni si të doni, një vend ku ata qe kanë falë gjaqet ndoshta shkojnë një herë në vjet edhe e shofin kontributin e tyre. Një kontribut jashtëzakonisht t’madh.

Une kom thonë m’dokët edhe një herë, ne si komb, si Kosovë i kemi dy të arritura të mëdhaja, dy fitore të mëdhaja. Fitorja e parë osht’, fitorja që e kemi arritë në Lëvizjen e madhe për Pajtimin e Gjaqeve, për t’pajtumen e mijëra familjeve. Fitorja e dytë osht’, çlirimi nga Serbia por nëse nuk e arrijmë edhe fitoren e tretë, që kjo rini me deshtë këtë shtetin tonë t’Kosovës, edhe ato dy fitoret e para janë t’kota. Nëse ne nuk arrijmë me kriju një shtet që rinia jonë do e donë edhe ato dy fitore janë t’kota. Nëse ne nuk arrijmë që... kom lexu me ni ven që Stipe Mesiçi e qunë, “prindë të përjetshëm” shtetin, nëse ne nuk investojmë në prind të përjetshëm, edhe ato dy fitore te mëdhaja frigothem që do jenë të kota.

*[Intervisuesja e pyet folësin rreth vjetërsisë së rasteve të famijleve të hasmuara. Pyetja është prerë nga video intervista.]*

**Riza Krasniqi:** Fatkeqësisht, osht’... kurrë na nuk kemi mbajtë statistikë për secilin gjak, sa vite ka qenë i vjetër. Edhe ka pasë raste t’dryshme. A e din osht’... kom lexu që ka ndodhë deri në pesedhjetë-gjashtedhjetë vrasje që ka pasë në të dy anët. Mirëpo, duhet ta dijmë që këto gjaqe kanë lindë si... apo janë rrjedhojë e mungesës së ligjit. E ka profesor Fatos Tarifa ni libër, “Hakmarrja është e imja”. Hakmarrja ka ekzistuar edhe në shtetet perëndimore, ka ekzistuar edhe n’Amerikë mirëpo, atje ma vonë ka dalë ligji, osht’ zbatu ligji edhe ligji e ka denu atë që ka bo keq, n’këtë rast vrasësin. Kur ligji e denon vrasësin, ti s’ke nevoj me u hakmarrë. Mirëpo nëse merret historia jonë, kur çdo herë ka mungu ligji, edhe kur vrasësi kurrë nuk o dënu, jo aq sa e meriton, po as për afërsisht qaq. Atëherë, n’botë çdo here, edhe tek ne, ekzistojnë njerëz që bajnë keq. Nëse dikush nuk i dënon ata, ata vazhdimisht do t’bajnë keq.

Prandaj, gjakmarrja në një kohë ka qenë element i domosdoshëm, se ka njerzë t'kqi që për çdo ditë e kishin vra dikend. Mos t'ishte frika si element i edukatës, që po ti e vrave dikush-dikend, dikush t'a vret fëminë tond, atëherë njerëzt e këqi kishin me ba vrasje çdo ditë. Prandaj po them, vrasjet jonë rrjedhojë e mungesës së ligjit, edhe une si Riza Krasniqi po flas. Mbas lufte, ni herë vetëm ka ardhë njeni kështu, "Hajde, hajde, eja se rasti osht' i tillë, veç po du me qenë kur t'pajtohen." Se mas luftës nuk jom marrë me pajtime, sepse mendoj që na duhet t'luftojmë që na ta krijojmë një shtet t'mirë, ku ligji osht' ligj edhe kur ligji do e ban, do e cakton denimin, jo njeriu. Prandaj, une prapë po them, unë do luftoj tërë jetën që Kosova ta ketë ni shtet, ta boj një ligj i cili do t'jetë i barabartë për t'gjithë. Dhe kur ta kemi ligjin, ashtu siç duhet, njerëzt nuk kanë nevojë me u marrë me gjakmarrje. Se me gjakmarrje nuk shkohet n'Evropë, me gjakmarrje nuk ecet përpara. Me gjakmarrje vetëm e shkatërrojmë njeni-tjetrin. E thomë kësisoji, ne do t'ecim përpara kur kryeministri nuk ia din numrin e telefonit kryeprokurorit, s'ka çka ia din. Po kur kryeministri, cilido që të osht', e din që për ni gabim, ka me u dënu.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë raste kur njerëzt nuk e kanë falë gjakun?

**Riza Krasniqi:** Shiqo, raste të tilla, çdo Lëvizje ka pasë. Asnihere, krejt populli nuk osht'... përkundër suksesit jashtëzakonisht t'madh që e kemi arritë, ne pajtimin e parë e kem ba me 10 shkurt në Raushiq. Për 80 ditë, Lëvizja ka arritë me i bledhë gjysë milioni njerëz te Verat e Llukës. Për mu osht' rast unikat n'histori, kur për 80 ditë prej 22 vetëve që kemi qenë n'ditën e parë në Raushiq, shumica prej të cilëve thashë, studenta dhe ish të burgosun politikë, për 80 janë ba 500 mijë vetë në përkrahje të Lëvizjes. Edhe atë ditë, kur jonë mbledhë 500 mijë vetë, nuk ka pasë telefona mobil. Nuk ka qenë mjetet sikurse sot, edhe çdokush që kem shku atë ditë, në njëfarë mënyre kemi shku me frikë, se krejt te Verat e Llukës ka qenë e rrethume me polic Serb. Kurrë s'kom pa ma shumë se atë ditë polic dhe tanka serbe. Nuk di... u ndijke ni fuqi, kurrë ma t'fuqishëm s'e kom ndi veten. Me iu thanë tankat, serbët, policët n'tana anët, po nuk di qysh, sot osht' e paspjegume, nuk jom frigu. Une u frigojsha përpara, n'Pejë, ni polic me pa, atë ditë shumë polic... shumë... noshta masa, noshta dëshira, vullneti i madh për me kontribu, nuk jom frigu.

Po them për 80 ditë kem arritë 500 mijë vetë me i mledhë, pse ka qenë qëllimi i mirë. Populli e ka kuptu qëllimin e Lëvizjes, ka qenë Lëvizje e ndershme, e udhëhequn prej njerëzve t'ndershëm, ku femna e ka kry rolin e vetë, ndoshta ma s'mirti në historinë e kombit tonë dhe e ka marrë pozitën që i takon. Ku parja nuk o përmend asnihere, në asni rast, nuk di une, as... se Serbia n'atë anë me siguri ka ba çmos me mujtë me i thanë dikujt, thuj m'i ka dhanë Anton Çetta 100 marka ose kështu, po nuk ka gjetë njeri t'tillë. Edhe po them, aq ka qenë punë e ndershme sa udhëheqësi i saj ka vdekë në një varfëri, mos t'thomë të skajshme.

**Jeta Rexha:** Ku ka qenë ky rast me 500 mijë njerëz?

**Riza Krasniqi:** Te Deçani, në 1990 te Verat e Llukës në ni fshat.

Aty thojshin se historikisht Isa Boletini e ka mbajtë një tubim edhe u vendosë që me mbajtë te Verat e Llukës, ku vetëm atë ditë diku 66 gjaqe jonë falë. Edhe osht', me sa e di une, deri sot tubimi ma i madh

që e kanë mbajtur shqiptarët, se tash pak me mahi unë thomë, krejt politikajtë e sodit me u mledhë, nuk mundën me i mledhë 500 mijë vetë. E n'atë kohë, as... kërkush prej tyre, mos t'them tash prej krejt kësaj as prej krejt kësaj Lëvizje, nuk di kush ka vazhdu me u marrë me politikë. Po m'duket, Adem Grabovci po m'kujtohet si emën që vazhdon me u marrë me politikë, edhe ato nuk e kom dëgju asnihere t'u thirrë në pajtime t'gjaqeve, lëvizje kështu... se asnjëni prej shokëve nuk osht' ... nuk ka vazhdu me u marrë me politikë. Nuk e ka keqpërdorë ate me thonë, "Eh unë jom konë në Pajtime të Gjaqeve, tash kjo meritokracia jonë".

**Erëmirë Krasniqi:** A po na spjegon qat' ditë çka ka ndodh, me ma shumë detaje?

**Riza Krasniqi:** Po, po, osht'.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh osht' vendosë?

**Riza Krasniqi:** Qysh po menon?

**Jeta Rexha:** Qysh o vendosë që o majtë në qat' vend edhe kush o marrë me vendimet? Qysh ka qenë?

**Riza Krasniqi:** Këshilli organizativ, unë nuk jom konë n'këshill organizativ, se patën fillu... qysh o vendosë? Mas ni kohe, n'fillim thashë jonë konë 20 krushqë t'pajtim, tash t'kthehem pak kronologjikisht. Ekipa e krushqve t'pajtim vazhdimisht filloi me u rritë. Diku javën e tretë, t'katërt, ma ekipa u deshtë me u nda. Anton Çetta mo nuk ishte në Pejë, vazhdoi me shku kah Drenica. Mbas ni kohe, fillunë me na pritë nëpër... se odat nuk nxejshin odat e burrave. Fillunë me na pritë nëpër livadhe, edhe kem na fotografi ku livadhet edhe krejt Anton Çetta me ekipë ose profesor Marku, edhe shumë ksajde... pa që edhe livadhet jonë... duhet masovizim. Edhe pastaj fillumë n'Rugovë, Mulla Xhevati për shembull, dy javë para Verave të Llukës e ka mbajtur ni tubim me 300 mijë vetë n'Bubavec. Edhe u pa si domosdoshmëri, mos t'thomë si kulm, në nji vend edhe u vendos te Verat e Llukës.

Çka u konë karakteristike atë ditë, për shembull mu m'kujtohet jom shku me profesor Ramiz Kelmendin prej Pejës, edhe ta merrke mendja që të gjitha rrugët nuk o mbetë kërkush, qytetarë në Pejë. E njejta ka qenë për Prishtinë, tregojshin njerëzit, kur Ramiz Kelmendi tha, "Rizë, asni njeri nuk o n'Prishtinë, krejt njerëzit te Verat e Llukës". Po them, jo që duket, po tash me i pa fotografitë duket e pabesushme n'atë kohë dikush mendon që osht' foto-montazhë ose diçka. Edhe rrugës kur shkova, p'e shoh Havën, thashë, "Havë!" "Profesor," tha, "deri n'tre ora t'natës, edhe dy gjaqe i kem falë". Thashë, "Ej çiko, a don ti me u kujtu se..." e di prej burgut si kujdestare ka pasë problem me shëndet. Thashë, "A don ti me e kqyrë pak për shnetën tonde apo?" Tha, "Profesor du me kqyrë për shnetën e Kosovës." Thashë, "Le bre, kqyre pak veten." Se ka qenë, ka pasë problem me shnetë. Tha, "Jo profesor, nuk osht' me randësi".

Pastaj Myrvetja, pastaj... krejt studentat atë ditë që... çka ka ndodhë në Deçan, ka ndodhë diçka që deçanasit kanë vendosë qat' ditë, fshati Llukë me rrethinë, kërkon mos me e lëshu pa bukë. Edhe paramendo, kur o kry, t'gjitha dyert jonë konë t'çeluna, që nanat tona kishin vendosë bukë, fli për njerëz që jonë pak ma larg Deçanit. Edhe atë ditë o tentu që kërkush mos me u kthy t'themi n'Prishtinë

ose n'Mitrovicë, ose n'Prizren pa hangër bukë. Me zor i kanë marrë njerëzt, me zor, "Hajde pak, prishja pak." Atmosfera që ka qenë atë ditë n'Deçan osht' e paspjegushme. Sot kur i shoh për shembull, se kanë qenë inçizimet e Radio Televizionit të Prishtinës, po m'duket ende i kanë t'rujtuna do inçizime. Osht' ni atmosferë, osht' ni plakë diku mos t'thomë 90 vjeçare, tonë kohën rrin me dy gishta qështu {ngritë dy gishta lartë}. Nuk di ku kish fuqi... osht' atmosferë kur dalin fëmia, 15 vjeçar osht' njeni nga profesor Zekerija Canës e thotë, "Unë kom vendosë me e falë gjakun e babës." Jonë do momente të cilat shumë vështirë osht' të harrohen, se ato vetëm një herë n'jetë përjetohen edhe osht' me fat ai që i përjeton. E kom pasë fatin me i përjetu, edhe m'vjen mirë se kom qenë me fat t'tillë.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh u përmyll kjo ceremoni, sa gjaqe janë falë? A u kthytë n'shpi sigurtë, meqenëse keni qenë të rrethum me tenka?

**Riza Krasniqi:** Jo, jo t'sigurtë. Atë ditë për shembull, profesor Zekerija Cana m'kujtohet, se ia qiti gjyksin kështu e i tha atij policit, "*Ubijte, ubijte!*" [Na vrani, na vrani!]. Se profesor Zeqa ka qenë ma trimi ndër ne, dhe e ka pasë atë guximin e lindur. Mirëpo, tash edhe ata, çka di une, serbëve nuk iu konvenonte tash me e vra profesor Zekerianë ose në prezencë para 500 mijë vetëve sepse kërkuj nuk i konvenonte me shpërthy aty. M'kujtohet pse e kanë rrehë rrugës, po nuk i numrojshim shumë atëhere, a din (qeshë). Kënaqësia që u pajtojshin gjaqet, kënaqësia që po punojmë diçka për Kosovën ishte shumë ma e madhe se krejt ato peripecitë...

Mu për shembull, m'kujtohet ni rast Enveri dhe Skenderi, ia u kishin mytë babën. Na para se me shku ekipi përgatitor, shiqojshim kush mundet me ndiku te ata. Edhe e gjetëm një kushëri t'afërt të tyre që ndikon. Shkumë dy herë, nuk e falën. Edhe profesor Antoni po iu thotë dikur, se t'gjithë që s'e falshin, thojshin, "N'rregull na jem me ju, po rasti im osht' ma specifik. Rasti im e ka kte, rasti im e ka kte..." secili i ka pasë, se secili gjak osht' histori n'veti. Nuk e falën edhe profesor Antoni po thotë, "Enver, Skender, ju djemë t'mirë, por na nuk mundem me ardhë mo." "Profesor, po na vjen keq, po nuk mundem me falë" "N'rregull." U kthymë. N'atë kohë punojsha si profesor n'gjimnaz të Pejës. Të nesërmit, të hanën domethanë, mësim prej tetëve, shtatë e gjysë sa ka qenë. Kur po shkoj njeni prej vëllaznëve para derës t'gjimnazit. "Mirëmengjes!" "Mirëmengjes!" "Profesor," tha, "a i ki dy minuta kohë?" Thashë, "Po more." Tha, "E kom ni lutje," thashë, "Fol," "a mundeni javën e ardhshme me ardhë te na?" Thashë, "Pse çka ka ndodhë?" Tha, "Kem vendosë me falë." Thashë, "Na promë kem," domethonë i bijke t'dillën, kah ora katër ishim nda prej tyne, thashë, "e nuk e falet. Çka ndodhi?" "Po," tha, "masi keni dalë ju, e kom ni kojshi ni serb edhe kur kom dalë, m'pyti 'Kush kenë qata?' E i thashë..." "A ke nxe nuse?" E ka pytë ai, "Se kenë shumë vetë." "Jo," thotë, "s'kom nxe nuse, po kenë qështu, qështu për me falë gjakun." "Ani çka bane?" Thotë, "Nuk e fala, se gjaku jem o konë ma...rast tjetër." "Eh," i thotë, "ti je burrë i burrave që s'e ki falë, se nime baba yt o konë kështu e s'o deshtë me falë." "Pra," thotë, "kur don me nxerrë gjakun" ai serbi i ka thanë, "nëse s'ki pushkë, pushkën ta japi une. Edhe burgut mos iu tutë, se n'burg nuk t'denojnë, se e di çfarë babe t'mirë ke pasë. Edhe pushkën e ke prej meje, edhe prej burgut une t'liruj." "Kur u ktheva," tha, "n'shpi, p'i thomë vëllaut qështu qështu." "Eh," tha, "dojmë me falë. Masi na ka thonë ai kojshia Stojani, 'Pushkën e keni prej neve, p'e shohim.'" Thashë, "Mirë bre Enver, u mundu profesor Anton Çetta dy herë me krejt ekipën

e s'të bindi, e Stojani t'bindi..." "Profesor," tha, "Stojani m'bindi." Edhe shkumë te ai, po mendoj shkumë t'dillën tjetër, e fali gjakun.

Domethanë, ka pasë edhe kësi, po pajtimi i gjaqeve, une mendoj që në atë lëvizje intelektualët kanë dështu pak se asnihere s'e kem përshkru çka kem pa krejt si duhet. Mu m'kujtohet ni rast n'Rugovë për shembull, osht' ni rast i vështirë. Edhe pse nuk ndodhë tek ne, njenit ia kishin mbytë vajzën, dhondri ia kish mbytë vajzën. Edhe shkumë dy-tri herë n'parapërgatitje, nuk... plaku "S'ban!" thojke. Atë dille kur shkumë, Azem Shkreli, Bajram Kelmendi, kanë qenë të Rugovës Ramiz Kelmendi prej... profesor Antoni ish n'Drenicë. Une tash pak prej frikës thashë, "Valla, Azem vështirë kemi me pasë se ekipa o dobësu." U deshtë me u nda në dy-tri grupe, thashë, "E pak jemi mbetë burra" a din n'atë aspekt. Azemi si Azemi m'ka thanë, "Rizë, burrat duhet atje n'Rugovë, na duhet... prej neve nuk lypet burrëni, prej atyne lypet, se ata kanë me falë". Shkumë te ai plaku, edhe nuk don me e falë gjakun. Edhe thotë, "Shiqoni, mu ma kanë..." tregon qysh ia kanë mytë vajzën, "m'i kanë lonë dy jetima." Thotë, "Jetimat po çohen natën, edhe..." se e kanë pa situatën qysh ia u kanë mbytë nanën, "edhe sot kom problem psiqik me ta." Edhe, Azemi ka qenë Azem, Azem Shkreli po mendoj edhe e ka pasë një fjalor jashtëzakonisht bindës, edhe filloi me e bindë.

Ai tha, "O burra, unë s'kom kujt me ia falë, se t'kisha kujt me ia falë, ia fali." Azemi tha, "Na nuk e njofim atë njeri, edhe nuk e lypim na n'emër t'tij. Po edhe qata jetimat tu, për qata jonë t'u luftu, se jetimat e tu kanë me ia pa hajrin kësaj falje, se do t'a ndërtojme ni Kosovë që këta kanë me u rritë si duhet. E jo nja çfare e kem sot". Edhe osht'... sa herë që Azemi me profesor Markun, Bajramin, e bindëshin. Ish ni kojshi aty i tij që thojke, "O burra, ky e falë, po e ka pak zor se çfarë çike ka pasë ky, n'shtatë katune nuk ka. Kur ia kanë pru çikën e mytne, une jom konë ngatë tij. Ju s'keni pa çka kom pa une e ky. Ky e falë, po jo sot se... a din, e prishke situatën." Dikur Azemi p'i thotë atij, "O burrë, jo t'gjithë që ta hajne bukën, ta dojnë t'mirën. Prandaj, për t'mirë t'Kosovës e..." e bindën njeriun, e fali gjakun. Kur e fali, tha, "Tash s'e keni qare pa e pi nga një kafe." "N'rregull, masi e fali gjakun." T'u e pi kafën, ai kojshiu që i thojke, "Valla" tha, "me emën kem kujtu që krejt Kosova me falë, ti s'ki me falë, se je konë trim e je konë burrë" (psherëtinë). Ofshau nihere ai baba i asaj vajzës tha, "Burra, me ju tregu t'drejtën, e paska falë Zoti, se masi na ka vra çikën, masi e ka kry burgun, e kom përcjellë me vra. Edhe para ni kohe o shku me nanën e vetë n'Pejë me shitë bylmet. Po, a vrahët ngatë nonës, nuk vrahët kurrë. Nuk e vras, s'kom moral me e vra vrasësin ngatë nonës t'vetë. Në mpromje e kom pa vetëm, jom shku iu kom afru me e vra, edhe kur iu kom afru, kom deshtë me dalë përpara, se nuk vrahët njeri përmas. E kom ni t'u folë me atë shokun e vetë, se e ka pytë ai 'Ku t'shkoi nona?' Thotë, 'Nona shkoi me e ble ni samun, se gjithë ditën s'kem hangër, e jem t'u dekë uni.'" "N'atë moment," thotë, "m'thirri diqysh baba prej vorrit edhe m'tha, 'Nuk vrahët njeri i untë' se n'kodin moral t'shqiptarëve, nuk vrahët njeri i untë' edhe thashë e vras sot ni javë. Ni javë kaloi, e ardhshme, e tona nuk dulë edhe e paska pasë falë, jo une, po Zoti".

Pastaj e komentojshim me Azem Shkrelin, "O Rizë," thojke, "nuk ekziston kërkun n'botë, asnjë kod, asnjë libër, asnjë film, ku shkrunë që nuk vrahët njeriu i untë, veç n'kodin e shqiptarëve, n'kodin moral t'shqiptarëve ekziston kjo që nuk vrahët njeriu i untë." Eh, une e kom thanë edhe disa herë, me pasë na

shtet si duhet, për këtë njeri bahet ni film, se nuk vrahët njeriu i untë. N'asnji vend në botë nuk e gjen nji kod moral të tillë. Pra, te Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve, kem pa edhe anën ma t'mirë tonën kombëtare, kem pa edhe vrasjet për të cilat nuk na shërbejnë fort.

**Jeta Rexha:** Sa kanë qenë krejt gjaqet gjithësej që i kanë falë deri n'fund t'procesit?

**Riza Krasniqi:** Po shiqo, edhe statistika shumë here jo falemnderuse, se çdo gjak osht' histori në veti. Prandaj mu t'themi edhe kështu, gjithmonë m'ka pengu, "Jo, une kom marrë pjesë n'kaq gjaqe." "Jo, une kom marrë pjesë n'kaq falje." Jo... simas disa shënimeve, se lëvizja ka vazhdu edhe mas 1 majit, megjithëse me intensitet ma t'dobët. Dikun manipulohet, jo manipulohet po thuhet që dikun 1500-1600 familje gjaqe jonë pajtu. Po nëse 1500 shumëzohet me dy, aty dalin tre mijë familje. Nëse këto familje, secila familje i ka pasë edhe pesë familje tjera, të cilat thashë edhe ma parë janë konë në mënyrë direkte ose indirekte të involvume, dalin 15 mijë. Nëse këto 15 mijë llogariten n'fshat nji anëtar me mesatare kah 10 anëtarë me i pasë, dalin 150 mijë vetë të involvumë këtu. Edhe del që mas kësaj lëvizje, 150 mijë vetë kanë marrë frymë ma lirisht. Pa e llogaritë, po thomë, edhe benefitet tjera.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh e keni kalu luftën? Lufta, qysh ju nxuni n'Pejë? Qysh e përballutë, çka keni ba?

**Riza Krasniqi:** (Psherëtinë) Lufta, qysh... lufta n'Pejë kur ka fillu, une me familje kemi shku n'Ulqin pastaj, edhe tërë kohën kom ndejtë n'Ulqin. E kisha shoqen shtatëzane edhe probleme të tjera të cilat i... normal që kur jom kthy prej luftës, çdo gja ka qenë e djegne. Mirëpo, prapë po them, ajo kënaqësia që jemi t'libër edhe vizita e parë që e kom bo si jom kthy, e kom pa shpinë e djegne komplet. Jom shku te vorri i babës kom folë pak me to njo gjysë ore edhe muj me i tregu që, "Babë, në Pejë mo nuk ka serbë, jemi çliru, flej i qetë!" Thashë, çdo herë m'ka ardhë keq se baba ka lindë dhe ka vdekë nën okupimin serb. Ka lindë n'vitin 1919 ka vdekë në 1996-tën. Edhe kur i thojsha, "Babë, fol diçka," se njeriu ka qef, "Babë," thojke, "çka kom me folë une, jom lindë nën shkije, po des nër shkije". Një atmosferë... edhe benë ma t'madhe baba e ka pasë, "Pasha vaktin e Shipnisë!" Kur... ato tri vite që ka qenë këtu Shqipnia e Madhe, ato tri vite i ka pasë t'vetmet vite n'jetë të cilat i ka gëzu. Po thomë, osht' ni bisedë që...une folsha, s'dijsha baba a po m'beson, a s'po m'beson (qeshë), n'atë stil.

Mas luftës pastaj kem vazhdu me ecë përpara, e me punu. Nuk jemi thirrë shumë n'këto veprimtari e n'këto se... une e konsideroj që njeriu e ka obligim, po them obligim me shkronja t'mëdhaja, me punu për çashtje kombëtare, sepse une nuk i kuptoj njerëzt të cilët thonë, "Po kontriboj për familje." Sepse për mu familja dhe shteti jonë, mos t'them si vëllaznit siamezë, edhe ma t'lidhun. Edhe nuk mundet kërkush me thanë, "E kom ni familje t'lumtun" në ni shtet jo t'zhvillumë. Bile, bile për mu, shumë ma me randësi osht' shteti, qajo familja e përhershme që thashë sesa familja, sepse shteti i zhvillumë edhe ni familje mesatare e çon përpara. Kurse, kur jeton në ni shtet jo t'zhvillumë edhe familjen ma t'mirë ta shkatërron. Nëse rinia, shumica mendojnë me jetu jashtë, atëhere ku osht' ... ku osht' qëllimi jonë.

Për ate ju them, çdo herë jom mundu me punu për shtet, edhe si profesor n'gjimnaz, edhe... s'do t'thotë që t'gjithë t'merremi me punë të mëdha. Për mu patriot i vërtetë osht' ai që punën e profesorit

e kryenë si duhet, se njeriu mundet çdokund me tregu atë patriotizmin e vetë. Patriot i mirë për mu sot osht' ni gazetar, ose gazetare e mirë e cila punën e vetë e kryen në mënyrë t'ndershme.

Për shembull n'atë kohë, se çdo herë njeriu mundet edhe duhet me punu për çashtjen kombëtare. E përmendet pare vitin '90 - '99, unë n'atë kohë kom punu edhe te ni argjentar n'Pejë, si këshilltar te Sali Kastrati. N'atë kohë kem ditë me caktu kësisoji, gjithë studentat e komunës së Pejës që e marrin notën mesatare ma t'madhe se tetë, e kanë pasë bursën nga një qind marka. Krejt qarshia e gatë n'Pejë, osht' ajo, ka dhonë pare për studenta. Kushti i vetëm o konë mos me bo dallavere. Ku o konë qëllimi? Qëllimi n'atë kohë ka qenë që studenti le t'menon qysh me bo notën mesatare tetë, mos t'mendon kush osht' anëtar komisioni. Mos t'mendon qysh me e gjetë intervencën për me e marrë bursën, po le t'mendon qysh me e kriju notën. Kur ai ta krijon notën, shoqnia le t'mendon për to. Une edhe para ni kohe kom thanë publikisht edhe... për mu edhe sot, se ndoshta pse kom punu ni kohë t'gjatë n'arsim, po une i besoj asaj shprehjes, "Aty ku arsimit osht' i smutë, edhe shteti osht' i smutë" edhe pse kjo osht' prej latinëve. Une edhe sot mendoj që sikur edhe ministri i arsimit ose me thanë, me dalë me ni deklaratë, t'gjithë ata kosovarë të cilët regjistrohen në një qind universitete më të mira në botë, dihet rang lista, do ta kenë bursën prej shtetit.

Automatikisht, mos t'them, qind për qind, kish m'u ngritë niveli në shkolla të mesme, sepse nxënësit n'shkolla t'mesme s'kishin me mendu mo, kush osht' anëtar komisioni për mjekësi? Kon me gjetë për intervencë? Këto jonë bisedat që zhvillohen n'shkolla te na. Por kishin me mendu, qysh me mësu që me u regjistru n'universitetet, se ai e din që n'universitetet e mira botërore nuk regjistrohet me intervencë, por me dije. Edhe na n'këtë mënyrë kishim m'e iu tregu nën një, që kemi shtet që mendon për rininë tone. Edhe nën dy, fmija jonë, unë djalit tem i kisha thonë, "Mso, babo, shtetin e ki, shteti po ta siguron shkollimin, mos lyp kurgjo prej meje." Edhe djali e kish hekë intervencën prej kokës. Se djali sot mendon, thotë, babë... p'i thomë Drinit, "Mso." Ai mson, por po thotë, "Babë, tjetri m'ka thonë një qind herë, 'Ti intervencë m'u regjistru n'fakultet t'mirë s'ke, pa intervencë nuk mujmë me t'regjistru.' Pse me msu une?" Edhe mu si prind po m'qet n'pozitivë t'keqe. Une n'këtë aspekt, e permenda pare rastin e... atij plakut që i pimë kafet n'Pejë, që patë thanë. Shoku i bankës që u martojke atë ditë edhe qato kafet që i pimë, i pimë me lot atë ditë. Edhe unë e falenderova atë.

T'kthehem n'këtë temë t'bisedës. "Faleminderit se rasti juaj ka qenë...," tha, "Jo, faleminderit prej juve". Ai po ma tregon rastin e vetë. Tha, "Ju e dini që e kam edhe një djalë?" Thashë, "Po," tha, "Mos t'a kisha falë," tha, "djali u konë e parapame m'u çu me vra atë tjetrin." Me nxjerrë gjakun e vllaut, çka u konsideru normale. Tha, "Sikur ta kish vra ato, sot djalin e kisha n'burg." Por u fal gjaku. Masi u fal gjaku, djali vazhdoi studimet, edhe vazhdoi shkollën, studimet. Edhe dikur tha, "Para dy muajve ka diplomu, n'fakultet," tha, "dita kur ka diplomu djali u konë dita ma e... n'jetën teme qat' gëzim s'e di, masi ma kanë vra djalin e vogël." E p'i tregoj, thashë, "Ah, masi t'paska diplomu djali, na, përgatitu, javën tjetër kemi me ardhë." Tha, "Pse keni me ardhë?" Se m'tregoi që... kur e tregoi rastin e dasmës, "Atje," tha, "po valon flamuri. Ata po hajne mish e pite, djali jem po han dhe." A e dinë, i kish ato.

E kom pas një shok para luftës prej Holandës edhe kur erdh te unë n'shpi, që osht' ngjarje e vërtetë, p'i kqyrim fotografitë, edhe p'e shoh një fotografi ku jom martu une n'viti 1990, flamuri ka qenë para

derës. “Riza, ky flamur?” Thashë, “Kur jom martu,” po bon m’e kry kështu {tund kokën}. “Pse çka?” Tha, “Te na, në qat’ regjion, n’Holandë, flamurin e qesim kur diplomon dikush n’fakultet, se qat’ ditë osht’ festë kombëtare.” Thashë, “Jo, te na shqiptarët e qesim kur martohem.” Tha, “Rizë, te na martohet edhe budalla, a duhet me qitë flamurin kombëtar kur martohet budalla, krejt kombi po u gzojka kur martohet budalla?” M’shtini me mendu, “Gëzim kombëtar,” tha, “osht’ kur dikush diplomon n’fakultet, se qat’ ditë lind një intelektual që ia sheh hajrin.” E tash p’i thomë atij plakut, “Edhe na kena me ardhë mas dy jave edhe kemi me qitë flamurin se t’paska diploma djali, se qatherë gëzohet kombi”.

**Erëmirë Krasniqi:** A jeni kthi në mësimdhanië mas luftës?

**Riza Krasniqi:** Jo, se kom pasë do plane tjera edhe kom realizu tjetër... mësimdhanja nuk m’i ka mundësu do... m’i shkollu fëmijët. O konë pak problem me... se n’jetë problemi ma i madh osht’ balancimi i intersit afatshkurtë dhe interesit afatgjatë. Shumë herë n’jetë interesi afatshkurtë na mashtron. Interes afatshkurtë osht’, po themi, me flejtë, me pushu, me thonë hajt se detyrat i boj nesër, hajt se ka kohë. Edhe n’çashtje kombëtare edhe shumë herë interesi afatshkurtë na ka shkatërru interesin afatgjatë. Osht’ mirë me mujtë me balancu midis këtyre dy intereseve. Por, realisht interesi afatgjatë, interesi afatgjatë ma i madhi për neve osht’ me investu n’shtetin tonë. Se une them nëse fmijët tonë dalin jashtë, fajtor jemi ne, jo ata. Nëse ne nuk iu krijojmë një shtet që ata me deshtë, na jemi fajtor, jo ata.

Se për mu ishte fatkeqësi, ose... po edhe osht’ fatkeqësi, viteve t’fundit, shumica e darsmave ose kanagjegjeve në t’cilat thërrasin, djali osht’ mbrenda, vajza osht’ jashtë ose e kundërta. Osht’ fatkeqësi kur një ish-nxënëse, para pesë-gjashtë viteve, m’pytë “Profesor, a ma mirë jetohe n’Gjermani a n’Zvicër?” I thomë “Pse?” Thotë, “Se i kom dy raste m’u martu, njëni n’Gjermani, tjetri n’Zvicër, me letra, qeshtu puna e letrave m’i kanë ofru.” Thashë, “E djemtë, cili osht’ ma i mirë? A e kqyrë ti djalin, a ma i mirë i Gjermanisë?” “Profesor”, tha, “une asnjonin nuk e njoh, po ku jetohe ma mirë po t’pys?” Domethanë, kemi arritë te një, për mu osht’ fatkeqësi kombëtare, martesë me letra. Pe marrë dikon n’Gjermani pse i ka letrat. E tash, shumica, mos t’them t’gjitha martesat, n’darsmat që kom shku vitet e fundit, n’Pejë po flas jonë qeshtu, qe. Osht’ fatkeqësi kur një plak n’Strellc thërret n’darkë dhe feston se djali i hastretit ia ka marrë letrat n’Gjermani, u martu me gjermankë. Çka feston plaku? Vetminë e vetë dhe humbjen e djalit. Por une nuk e fajësoj djalin, nuk e fajësoj rininë. Na jemi fajtor, na gjenerata ime, nëse nuk e krijojmë një Kosovë t’cilën fmija jonë kanë me deshtë sa duhet dhe si duhet. E ky osht’ interesi ma madhor dhe interesi ma afatgjatë për t’cilin duhet punuar.

**Jeta Rexha:** Zoti Riza, me iu pytë diçka...

**Riza Krasniqi:** Jo sa t’dush pytë, hiç mos t’vjen keq (qeshje).

**Jeta Rexha:** Kur na keni folë pak për gjyshin e jujë Cen Avdylin, që e ka një kangë, qysht osht’?

**Riza Krasniqi:** Mos po del personale?

**Jeta Rexha:** Paj, qajo edhe osht’ idea. Në qoftëse doni.



**Riza Krasniqi:** Jo, unë e thomë me mburrje, se une mburrna me to.

**Jeta Rexha:** Mendoj që kjo e kish plotësu pak.

**Riza Krasniqi:** Ani ani, s'po du me bo ata, promovimin e paskrupulltë të vetëvetës.

**Erëmirë Krasniqi:** Jo, osht' ai edukimi familjar edhe tradita jote që osht' përcjellë brez mas brezi. Osht' edhe çka na vyn tash.

**Riza Krasniqi:** Po tregova që baba, çdo herë natën e *bozhiqit* na ka mbledhë, edhe temë ka qenë qysh ia kanë vra babën. Baba im ka qenë Ahmet Riza, domethanë se në fshat i kanë thirrë n'bazë t'prindëve. Une e kom emrin e gjyshit.

Populli jonë çdo here i ka deshtë trimat, edhe ia kanë knu kangën. Kanga e Cen Avdylit, sot me hy n'internet, osht' shumë e klikume, e knojnë Vëllazërit Qetaj, e knojnë disa varianta. Por, ni plak, domethanë kur don njeriu me luftu e gjen metodën. Edhe baba çdo here neve natën e *bozhiqeve* na ka rritë me këtë... për çdo natë të *bozhiqit* o përmend historia familjare, qysh serbët ia kanë shkatërru ardhmërinë e babës tem. Prandaj n'familjen tonën kurrë nuk o folë mirë për serbët sepse e kanë shkatërru ardhmërinë e familjes, edhe ma kanë lanë babën tre mujshë. Thashë, babai m'ka vdekë pa e ditë çka osht' baba, nana, vëllau, motra, familja. T'vetmit që ka pasë, na ka pasë neve. Kjo osht' ... ambienti në të cilin unë dhe familja ime jemi rritë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ia tregon këtë tregim fëmijëve t'jujë, a ua keni përcjellë?

**Riza Krasniqi:** Po, megjithëse tash fëmia pak ma... une e di n'fillim, kur ishin fëmia ma t'vegjël, pat' dalë CD-ja edhe une e lëshova disa herë me mburrje. Vajza e cila i kshte shtatë vjet, gjashtë vjet e gjysë, e dyta tha, "Babi ndrrona!" Thashë, "Pse bre babi? Osht' kanaga e babgjyshit tond." Tha, "Le ta knon Genta babi." Thashë, "Po babi, Genta nuk knon kësi kangë" (qeshë). Tha, "Valla pa e knu Genta nuk... " (qeshje), kjo osht'. Po e dini normal që... familja osht' e shejtë e çdo kulture botërore, familja osht' qeliza. Randësia e familjes, randësia e edukatës osht' e para... osht' qaq e madhe sa... mirëpo, çdo kohë po ndryshon nga pak, po thojnë, "Ec në hap me kohën". Po them, për mu sot osht' shumë ma me randësi osht' fëmia, nëse msojnë, se une e kam thanë publikisht edhe prapë do e them, nëse për shembull, aty osht' suksesti, te fëmia jonë, këtu {tregon me dorë}, e vetmja rrugë osht' libri. E vetmja rrugë osht' dituria për me arritë deri te suksesti.

Pavarësisht se në ca momente të caktume, duket që osht' rrugë e vështirë e... pavarësisht na duket që ndoj dallavergji po e arrin suksesin me dallavere n'këtë anën tjetër. Pavarësisht sa jonë momente që të demotivojnë, "U çu ky far dallavergjie kurrë kurgjo n'jetë s'ka ditë, e me dallavere kqyr çka bani." Unë du me besu edhe besoj që dituria osht' e vetmja rrugë n'jetë, e vetmja rrugë që duhet drejt suksesit. Prandaj edhe sot mundohna fëmijtë me i eduku që vetëm me anë të diturisë do të jenë të suksesshëm. Rrugë t'tjera mund të dërgojnë te ni pasuri momentale, por nuk osht' rrugë e suksesit.

**Erëmirë Krasniqi:** A keni diçka me shtu, diçka që kishte me mujtë me plotësu rrëfimin?

**Riza Krasniqi:** Lutje gjeneratës sime ma t’vjetër, t’punojnë për këtë rini. Kemi ni rini t’shkëlqyeshme, shembullore që nuk e ka kërkush n’botë. E ndonjihere me do gjeste t’rana, me sukses po ua shkatërron ardhmërinë e tyre. Prandaj, t’mendojmë pak ma gjatë, t’mendojmë për ni shtet tonë ku rinia kish me e gjetë veten. Mos t’mendojmë që kjo rini e jona qysh të shkon n’Gjermani, qysh të shkon n’Amerikë. T’bajmë çmos që qat’ Gjermani, sa ma shumë t’iu a krijojmë mrenda Kosovës, kjo kish me qenë një porosi e imja.

**Erëmirë Krasniqi:** A mundeni me na folë diçka për Nurie Zekaj, meqenëse e keni pasë studente?

**Riza Krasniqi:** Me kënaqësi flas Nurinë, se Nurinë e kom pasë nrxanëse n’Pejë n’atë kohë edhe ka qenë ndër nrxanëset ma t’mira. Po përveç shkollës, si nrxanëse, Nurija i ka pasë edhe disa veti tjera të cilat kanë qenë pak ma t’rralla n’atë kohë. Nurija osht’ një ndër t’parat që osht’ marrë me shkrime dhe e ka një libër t’poezive që ia kanë botu mas vdekjes. Nurija osht’ marrë me çashtje kombëtare se ka pasë lidhje t’afërt me Have Shalën, m’duket çika t’hallës. Edhe në Lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve ka qenë prej ditës t’parë. Mirëpo, fatkeqësisht jeta e saj u ndërpre shumë heret sepse në një udhëtim t’saj me një shok tjetër nga Maqedonia, i cili po ashtu ka qenë aktivist, ka vdekë në një vdekje të dyshimtë në një fatkeqësi komunikacioni, për n’atë kohë shumë të dyshimtë. Na në atë kohë nuk kena pasë instrumente me e vërtetu sa ka qenë ajo montim i sigurimit shtetëror, sa ka qenë gabim njerëzor. Por, Nurijen çdo here e kom kujtu me respekt dhe do e kujtoj me respekt. Ka rrjedhë nga një familje e Raushiqit, shumë e ndershme, ni familje që me çashtje kombëtare jonë marrë vazhdimisht. Ka qenë në grupin që e përmenda, gjatë pajtimeve, grupin e vajzave apo femnave, çuje qysh t’dush. Sa here që na jemi dorëzu n’odën e burrave, ato e kanë vazhdu punën për pajtime.

**Erëmirë Krasniqi:** Kur ka ndodhë aksidenti i saj?

**Riza Krasniqi:** Në ’90-tën.

**Erëmirë Krasniqi:** Mas pajtimeve apo në ndërkohë?

**Riza Krasniqi:** Jo, në ndërkohë ka qenë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka qenë pjesë e presionit edhe përndjekjeve politike? Po mendoj, a ka pas presion për vajzat që kanë qenë të angazhume në Pajtim?

**Riza Krasniqi:** Presion prej sigurimit shtetëror kem pasë vazhdimisht, po presionet kanë qenë në mënyra t’ndryshme. Se pas ni kohe ata jonë konë t’meçëm, edhe me marrë me vra dikend, ajo i jepke kontra efekt në atë kohë. Unë e tregova rastin kur jena shku te njëri, i kanë thanë, “Hajt se ta japim armën”. E presione vazhdimisht kem pasë.

**Erëmirë Krasniqi:** Janë përcjellë?

**Riza Krasniqi:** Po mos t’ishin kanë qato presione, as lëvizja për pajtimin nuk kishte me ndodhë. Pikërisht ato presione, kanë ba që me ardhë deri te lëvizja për pajtimin e gjaqeve.

**Erëmirë Krasniqi:** Naj koment tjetër, diçka që iu kujtohet në lidhje me Nurinë, rreth shkrimeve të saja?

**Riza Krasniqi:** Si çdo poeteshë e re, e kishte një kënaqësi kur shkrujke diçka, edhe menxi s'pritke... ndoshta pse nga natyra jom konë ma i afërt, "Profesor, qysh kom shkrujtë, qysh po t'dukjet, qysh...?" Ishte një kënaqësi e jashtëzakonshme në ftyrën e saj tre rreshte kur i shkrujke. Edhe normal si profesor, ti e ki obligim me i dhonë vullnet. Thojsha, "Nurije, t'lumtë, të lumtë. Je një poeteshë e re..." "A veç poeteshë?" "Jo, jo ti ke me arritë shumë ma shumë n'jetë." Edhe sinqerisht kom besu që ka me arritë shumë ma shumë n'jetë, por fatkeqësitë e mëdhaja ndodhin, çka me bo... janë pjesë e jetës.

**Erëmirë Krasniqi:** Shumë faleminderit!